



**Republika e Shqipërisë
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

RAPORT

Për

Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2019



TIRANË, SHKURT 2020

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

I. PJESA E PARË – PERIUDHA PARAZGJEDHORE

| | |
|---|--------|
| I.1 PLANI I VEPRIMIT NË ZGJEDHJE | Fq. 3 |
| I.2 AKTE TË KQZ-së | Fq. 4 |
| I.3 BASHKËPUNIMI i KQZ-së me organet e qeverisjes vendore | |
| I.3.1 Përgatitja e listës së zgjedhësve | Fq. 5 |
| I.3.2 Marrja e informacionit për qv-të, zgjedhësit në to, hartat zgjedhore, qv-të në ambiente private. | Fq. 7 |
| I.4 BUXHETI DHE FONDET | |
| I.4.1 Buxheti i KQZ-së për vitin 2019 | Fq. 8 |
| I.4.2 Buxheti i KQZ-së për zgjedhjet | Fq. 9 |
| I.4.3 Financimi i subjekteve zgjedhore, pjesëmarrëse në zgjedhje dhe të Partive Politike për vitin kalendarik 2019 | Fq. 10 |
| I.5 PLANIFIKIMI | |
| I.5.1 Logjistika zgjedhore | Fq. 11 |
| I.5.2 Burimet Njerëzore në KQZ | Fq. 11 |
| I.5.3 Prokurimet | Fq. 16 |
| I.6 NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I ADMNISTRATËS ZGJEDHORE | |
| I.6.1 Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore | Fq. 16 |
| I.6.2 Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve | Fq. 17 |
| I.6.3 Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve | Fq. 24 |
| I.6.4 Ngritja dhe funksionimi i GNV-ve | Fq. 26 |
| I.7 TRAJNIMET | |
| I.7.1 Zhvillimi i procedurave të përzgjedhjes së kandidaturave të trajnerëve | Fq. 28 |
| I.7.2 Zhvillimi i trajnimeve | Fq. 30 |
| I.8 INFORMIMI | |
| I.8.1 Edukimi i votuesve | Fq. 31 |
| I.8.2 Shoqëria | Fq. 35 |
| I.9 REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE | |
| I.9 Regjistrimi i partive politike në zgjedhje | Fq. 38 |
| II PJESA E DYTË – PERIUDHA ZGJEDHORE | |
| II.1 Akreditimi i vëzhguesve | Fq. 42 |
| II.2 Monitorimi i fushatës zgjedhore dhe vëzhgimi i procesit | Fq. 43 |
| II.3 Aksesi i medias | Fq. 44 |
| II.4 Fleta e Votimit | Fq. 44 |
| II.5 Përgatitja dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQZ në KZAZ dhe nga KZAZ në KQV | Fq. 45 |
| II.6 Dita e zgjedhjeve | Fq. 46 |
| II.7 Dorëzimi i materialit zgjedhor në KZAZ-të pas mbylljes së QV-së | Fq. 48 |
| II.8 Procesi i numërimit në VNV, tabulimi dhe nxjerrja e rezultatit nga KZAZ | Fq. 48 |



| | | |
|--|---|--------|
| II.9 | Publikimi i rezultatit paraprak, nxjerrja e rezultatit nga KQZ, rezultati përfundimtar | Fq. 49 |
| II.10 | Ankimet dhe statusi i tyre | Fq. 50 |
| III PJESA E TRETË – PERIUDHA PASZGJEDHORE | | |
| III.1 | Financimi i partive politike | Fq.55 |
| III.1.1 | Auditimi i partive politike për vitin kalendarik 2018 | Fq.55 |
| III.1.2 | Financimi i subjekteve zgjedhore në zgjedhjet 2019 | Fq.56 |
| IV PJESA E KATËRT - VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË | | |
| IV.1 | Marrëdhëniet me institucionet e tjera | Fq.59 |
| IV.2 | Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal | Fq.60 |
| IV.3 | Partneriteti, KQZ-Organizma Ndërkombëtare | Fq.61 |
| IV.4 | Vëzhgimi i proceseve zgjedhore | Fq.63 |
| V PJESA E PESTË - VERIFIKIMI I VETËDEKLARIMEVE TË FUNKSIONARËVE PUBLIKË (DEKRIMINALIZIMI) | | |
| | | Fq.64 |
| V.1 | Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit për kandidatët për deputet gjatë plotësimit të vakancave për vitin 2019 | Fq.64 |
| V.2 | Shqyrtime të rezultateve të verifikimeve të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2019 | Fq.66 |
| V.3 | Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për Kryetar bashkie dhe anëtarë në këshillat bashkiak, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019. | Fq.68 |
| V.3.1 | Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, gjatë procesit të plotësimit të vakancave të krijuara për vitin 2019 | Fq.69 |

I. PJESA E PARË – PERIUDHA PARAZGJEDHORE

I.1 PLANI I VEPRIMIT NË ZGJEDHJE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe të nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018, caktoi datën 30 qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore 2019.

KQZ, në kuadër të detyrimeve ligjore lidhur me organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, miratoi një nga vendimet më të rëndësishme për procesin zgjedhor, vendimin nr. 33 datë 19.11.2018 “Për miratimin e Planit Orientues të Veprimeve të KQZ-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”. Veprimet që parashikohen në këtë



Plan Orientues të Veprimeve, burojnë nga detyrimet e përcaktuara nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe nga zbatimi i tyre në praktikë.

Plani Orientues i Veprimeve është një kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore mbi të cilat u mbështetet aktiviteti i mëtejshëm i KQZ-së. Në Planin Orientues të Veprimeve u parashikuan të gjithë aktet nënligjore, të cilat KQZ duhet të nxirrte në zbatim të Kodit Zgjedhor (vendime, udhëzime, akte normative dhe akte të tjera), akte nënligjore, të cilat do të rregullonin marrëdhënie të caktuara për herë të parë, si dhe të rishikonin aktet në fuqi si pasojë e ndryshimeve në ligj ose nevojave të lindura nga praktikatat e mëparshme zgjedhore, apo që diktohen nga rekomandimet e OSBE/ODIHR për zgjedhjet.

Detajimi i veprimeve konkrete dhe i afateve kohore, brenda të cilave duhet të ndërmerren këto veprime në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Zgjedhor, ndihmojnë KQZ-në të kontrollojë në çdo moment ecurinë normale të procesit zgjedhor, ndihmojnë partitë politike, vëzhguesit vendas dhe të huaj, median dhe në përgjithësi publikun e gjerë, të orientohen në realizimin e procedurave dhe njëkohësisht të kontrollojnë ecurinë e procesit dhe veprimtarinë e KQZ-së.

I.2 AKTE TË KQZ-së

KQZ, gjatë vitit 2019 ka nxjerr gjithsej 1097 akte. KQZ, përveç akteve të nxjerra në kuadër të administrimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit “Për Partitë politike”, ka nxjerr dhe akte në lidhje me zbatimin e ligjit 138/2015, dhe akte për plotësimin e vakancave të krijuara në Kuvendin e Shqipërisë.

Në raport me objektin e këtyre vendimeve, pjesa më e madhe e tyre ka shërbyer për:

- Regjistrimin e subjekteve zgjedhore në KQZ (regjistrimin e partive politike, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit dhe listave shumëmemërore);
- Miratimin e modeleve të kandidimit;
- Miratimin e strategjisë për trajnimin e komisionerëve zgjedhorë, si dhe të strategjisë për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet Organet e Qeverisjes Vendore 2019;
- Miratimin e dokumentacionit të punës për komisionet e niveleve të dyta e të treta;
- Miratimin e manualeve zgjedhore për çdo nivel të administratës zgjedhore;
- Emërime dhe zëvendësime të komisionerëve zgjedhorë;
- Miratimin e listave shumëmemërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KZAZ-ve dhe KQV-ve;
- Miratimin e modeleve të materialeve zgjedhore;
- Monitorimi i fushatës zgjedhore në media;



- Miratimin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit;
- Miratimin e vëzhguesve vendorë dhe të huaj;
- Nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve për 10 bashkitë e mëdha të cilat u administruan nga më shumë se një KZAZ;
- Përlllogaritja e mandateve dhe ndarja e tyre për çdo subjekt zgjedhor për 61 Këshillat Bashkiak;
- Vendime për kërkesat ankimore.

Vendimet e KQZ-së janë të vlefshme kur votojnë pro shumica e anëtarëve të saj, me përjashtim të disa vendimeve të shprehura në mënyrë shteruese nga Kodi Zgjedhor, miratimi i të cilave kërkon votën pro të shumicës së cilësuar të 5 anëtarëve të KQZ-së.

1.3.1 Përgatitja e Listës së Zgjedhësve, përgjegjësi e zyrave të gjendjes civile, pranë qeverisjes vendore nën drejtimin e kryetarit të bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe nën drejtimin e Ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019, ky proces filloi në 4 dhjetor 2018. Një muaj me pas, ekstrakti i përbërësve zgjedhorë u publikua (në letër) pranë zyrave të gjendjes civile në bashki dhe elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Gjithashtu, u publikua në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së. Lista paraprake e zgjedhësve ju nënshtrua një procesi rishikimi edhe në bazë të kërkesave të zgjedhësve. Publikimi u përsërit nga organet përkatëse në mënyrë periodike çdo 30 ditë, deri në shpalljen e listës përfundimtare të zgjedhësve, 40 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Kodi Zgjedhor i ka caktuar KQZ-së rolin mbikëqyrës në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve. Këtë rol KQZ-ja e ka realizuar duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore gjatë procesit të përgatitjes së listave të zgjedhësve. KQZ ka vendosur të ndërhyjë nëse e ka arsyetuar të nevojshme.

Për realizimin e Zgjedhjeve Vendore 2019, KQZ-ja mbikqyri drejtëpërdrejt veprimet në bazën e të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile për hartimin e listave të zgjedhësve, nëpërmjet dy auditëve teknikien të emëruar sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Veprimtaria e auditëve teknikien është rregulluar me një akt normativ të miratuar nga KQZ. Raportet periodike mujore të auditëve teknikien u diskutuan në mbledhjet e KQZ-së me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore.

Problematikat e konstatuara gjatë diskutimit të raporteve të auditëve teknikien u janë adresuar për zgjidhje të gjithë institucioneve përkatëse, si Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Njësisve Përkatëse Vendore, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Agjencisë Kombëtare të



Shoqërisë së Informacionit.

Sipas konkluzioneve të auditeve teknikien:

- Ekstraktet janë gjeneruar brenda afateve ligjore në respekt të pikave 5 dhe 7, të nenit 51 të Kodit Zgjedhor.
- Është publikuar On-Line lista e zgjedhësve në faqen Web të KQZ.

Në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile është raportuar identifikimi i zgjedhësve me kode banimi 000, 888, 999 i cili ka ardhur, duke u ulur nga 284,065 zgjedhës në ekstraktin e parë datë 04 Dhjetor 2018, në 727 në listën finale të ekstraktit përfundimtar.

Ky numër i madh ka ardhur si pasojë e mos paraqitjes së qytetarëve pranë ZGJC për të përditësuar të dhënat e tyre. Për zgjidhjen e kësaj problematike është raportuar pranë Ministrisë së Brendshme dhe është zhvilluar një takim me stafin e ZGJC dhe përfaqësues të pushtetit vendor të zyrave të urbanistikës.

Një problematikë tjetër e evidentuar nga analizimi i ekstrakteve zgjedhore është përfshirja dhe heqja e zgjedhësve të cilët kanë moshën e votimit mbi 100 vjeç në datën e zgjedhjeve.

Kodit Zgjedhor, Neni 51 përcakton se, *“Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë pika 1 përcakton që: Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, jo më vonë se 5 ditë nga dita e dekretimit të datës së zgjedhjeve, urdhëron zyrat e gjendjes civile të fillojnë procesin e hartimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në përputhje me këtë Kod. Jo më vonë se 15 ditë nga dita e dekretimit, zyra e gjendjes civile nxjerr në format elektronik ekstraktin me përbërësit zgjedhorë të të gjithë shtetasve me të drejtë vote në datën e zgjedhjeve, me përjashtim të shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç deri në këtë datë”*.

Bazuar në informacionin e dhënë nga ana e DPGCJ, ky grup zgjedhësish u hoq nga ekstrakti i parë duke u vendosur kodin QV 8899 dhe pastaj në vazhdimësi u shtuan në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në ekstraktin e datës 28 Prill 2019, rezultoni të përjashtuar 1087 zgjedhës të këtij grupimi, ndërsa në ekstraktin e listës finale rezultoni të përjashtuar **2,797** zgjedhës të këtij grupimi

Sipas Kodit Zgjedhor kryetari i njësisë vendore kur një zonë qendre votimi ka mbi 1000 zgjedhës vendos për krijimin e qendrës shtesë të votimit brenda të njëjtës zonë dhe kur një qendër votimi ka nën 200 zgjedhës e bashkon atë me qendrën e votimit më të afërt. Në procesin e përgatitjes së listës së zgjedhësve u konstatuan disa raste të shkeljes së këtyre kriterëve.

Me ndërhyrjen e KQZ-së dhe DPGJC-së, ky fenomen në listën përfundimtare u normalizua.



Për Zgjedhjet Vendore 2019, u caktuan gjithsej **5417** Qendra Votimi. Për të mos krijuar asnjë shqetësim më sasinë e fletëve të votimit për çdo QV, administratës së KQZ-së ju desh të kryente një kontroll midis të dhënave të marra nga kryetarët e njësive vendore dhe DPGJC-së, me ato të listave të zgjedhësve që administrojnë KZAZ-të.

I.3.2 Bashkëpunimi i KQZ-së me organet e qeverisjes vendore, marrja e informacionit për QV-të, zgjedhësit në to, hartat zgjedhore, QV-të në ambiente private.

Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, cakton zonat dhe shpall vendndodhjet e qendrave të votimit sipas kriterëve dhe afateve të përcaktuara në nenin 62 të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja me Udhëzimin nr.1, datë 12.12.2012, “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurat dhe afatet e realizimit të këtyre detyrave nga njësitet e qeverisjes vendore.

Menjëherë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve, KQZ-ja adresoi për të gjithë kryetarët e bashkive kërkesën për dërgimin në afat të të dhënave për caktimin dhe vendndodhjen e qendrave të votimit, duke risjellë në vëmendje kriteret dhe procedurat ligjore për:

- për krijimin e një qendre votimi shtesë brenda zonës së qendrës së votimit;
- bashkimin e zonës së qendrës së votimit, që ka më pak se 200 zgjedhës me një zonë qendre votimi tjetër;
- përgatitjen e hartës zgjedhore për çdo zonë qendre votimi;
- t’i propozuar KQZ-së miratimin e qendrave të votimi në ndërtesa private, detyrimin për të referuar të dhënat që përcakton Kodi Zgjedhor, të detajuara nga KQZ me akt normativ, etj.

Kryetarët e Bashkive, sikundër edhe në procese zgjedhore pararendëse, përgjithësisht nuk respektojnë afatet ligjore për dërgimin e të dhënave, veçanërisht për propozimet për caktimin e qendrave të votimit në ndërtesa private. Për të shmangur vonesat dhe mungesat në dërgimin e informacionit, KQZ-ja u detyrua të ripërsërisë kërkesat, përmes komunikimit shkresor ashtu edhe përmes deklaratave publike.

Pavarësisht se nga procesi në proces, numri i qendrave të votimit në ndërtesa private ka shënuar rënie, administrimi i dokumentacionit, dërgimi i propozimeve jashtë afateve apo me mangësi të të dhënave, kryerja e procedurave dhe verifikimeve, investon KQZ në kohë dhe burime njerëzore, në një kohë të ngarkuar me angazhime, punë dhe vendimmarrje për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor. Verifikimet në terren dëshmojnë moszbatimin korrekt të kriterëve ligjore në disa raste, ku propozimi bazohet në argumentin se vendndodhja e qendrës së



votimit kishte të njëjtën adresë me zgjedhjet e kaluara, pa referuar mundësitë objektive të ndërtesave publike në zonën e qendrës së votimit apo në zona qendre votimi fqinje.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të propozimeve të Kryetarëve të Bashkive, kryerjes së verifikimeve përkatëse, caktoi vendodhjen e 374 qendrave të votimit në ndërtesa private.

Caktimi i vendodhjes së Qendrave të Votimit në ndërtesa private, kryesisht bare dhe restorante, përtej problematikave që shkakton zbatimi i procedurave, kryerja e verifikimeve, si dhe faktit që subjektet zgjedhore kundërshtojnë/debatojnë mbi bazë argumentash, që jo në pak raste është vështirë të provohen, ofrojnë imazh të papërshtatshëm për t'u përdorur si qendra votimi. Ministri i Brendshëm, në vlerësim të këtyre problematikave, i sugjeroi KQZ-së mundësinë e zgjedhjeve alternative përmes qendrave të përkohshme të votimit të lëvizshme, të cilat mund të vendosen në hapësirat publike. Adresimi i këtyre shqetësimeve, si dhe vlerësimi i zgjedhjeve alternative është përtej kompetencave të KQZ-së, pasi kërkon rregullime ligjore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka realizuar takime konsultative në bashkitë e vendit me qëllim trajnimin e strukturave administrative vendore për shmangien e neglizhencave apo zgjedhjeve të sforcuara në afatet e ngushta kohore për të përmbushur përgjegjësitë për propozimin e caktimit të qendrave të votimit në ndërtesa private. Në këto takime, theksi është vënë për vëmendjen, që duhet t'i kushtohet aksesit të Qendrave të Votimit nga personave me aftësi ndryshe.

KQZ, në periudhën 40 ditë para datës së zgjedhjeve, në vlerësim të situatës dhe propozimeve të Prefektëve të disa Qarqeve dhe KZAZ-ve respektive, dha autorizim për ndryshimin e vendndodhjes së 234 qendrave të votimit. KZAZ-të afishuan menjëherë listat e zgjedhësve në ambintet e reja ku ishin caktuar QV-të dhe bënë përpjekje maksimale për informimin e zgjedhësve të rregjistruar në këto Qendra Votimi, për vendodhjen e tyre të re.

1.4 BUXHETI DHE FONDET

1.4.1 Buxheti i KQZ-së për vitin 2019

Për vitin 2019, KQZ-së ju vunë në dispozicion 162.300.000 lekë në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për shpenzimet e administratës për paga dhe sigurime, shpenzime për mallra dhe shërbime si edhe për shpenzime kapitale.

Në zbatim të buxhetit të akorduar u realizuan procedurat prokuruese, për sigurimin e bazës materiale për funksionim e institucionit, konform legjislacionit në fuqi të prokurimeve publike. Në fondet e miratuara në buxhetin e institucionit për vitin 2019, përfshihej edhe fondi për



rikonstrukcionin e një prej magazinave të bazës materiale në Lundër, si edhe blerja e një sërë pajisjesh informatike. Fondet, të cilat u çelën në kohë nga Ministria e Financave, u prokuruan nga KQZ-ja dhe në përfundim u realizua rikonstrukcioni i magazinës së bazës materiale në Lundër.

Me qëllim përballimin e efektit të rritjes së pagave të antarëve të KQZ-së, me hyrjen në fuqi të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në datë 1 janar 2019, KQZ-së iu vunë në dispozicion 10 milionë lekë shtesë në buxhetin e institucionit për vitin 2019.

1.4.2 Buxheti i KQZ-së për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore

Me ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve iu akordua një fond prej 600 milionë lekësh për zhvillimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2019.

Kodi Zgjedhor, parashikonte risi edhe sa i përket infrastrukturës, që do të përdorej për zgjedhje, realizimi i së cilave përkonte me një kosto financiare më të madhe nga ajo e parashikuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin nr.26, datë 11.02.2019, ka miratuar strukturën e shpenzimeve buxhetore për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019, duke parashikuar një strukturë buxhetore në shumën totale prej 818 milionë lekë, (nr.zgjedhësve 3.546.805) me kosto për një zgjedhës rreth 230 lekë.

KQZ-ja e motivuar për ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve zgjedhore, eliminimin e të gjitha dobësive potenciale, që mund të shkaktohen gjatë një procesi zgjedhor për shkaqe ekonomiko-financiare, kërkoi shtesë fondi në programin e zgjedhjeve, shtesë e cila u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.416, datë 21.06.2019 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019”, në shumën 200 milion lekë.

Duke analizuar strukturën buxhetore të zgjedhjeve të përgjithshme rezulton se 8.97 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore të personelit të përkohshëm, 26.8 % e fondit është akorduar për pagesën e komisionerëve të të gjitha niveleve, 64.24 % të fondeve është akorduar për shpenzime për mallra dhe shërbime.

Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacionin në fuqi për manaxhimin e fondeve publike. Nga 800 milionë lekë të akorduara, u realizuan 658 milionë lekë ose 82% e fondeve të akorduara. Diferenca prej 142 milionë lekësh konsiston në 64.612 milionë lekë në zërin paga për personelin e përkohshëm dhe 77.443 milionë lekë në zërin shpenzime për mallra dhe shërbime.



1.4.3 Financimi i partive politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019.

Neni 87/1 i Kodit Zgjedhor përcakton se subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, financohen nga fonde publike dhe jopublike. Fondet publike për këtë qëllim vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe ndahen me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas formulës së përcaktuar në Kodin Zgjedhor.

Këshilli i Ministrave me VKM nr.377, datë 06.05.2019 “Për një shtesë fondi në programin “Mbështetje për partitë politike”, për financimin e fushatës zgjedhore, të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore”, akordoi shumën prej 65 milionë lekësh për t’ju shpërndarë partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, për fushatën zgjedhore.

KQZ-ja shpërndau fondin prej 65 milionë lekësh, partive pjesëmarrëse në zgjedhje me Vendimin nr. 830, datë 10.06.2019 “Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do t’u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”, bazuar në përcaktimet e nenit 87/3 të Kodit Zgjedhor.

Me daljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, fondi prej 65 milionë lekësh u rishpërnda nga KQZ me Vendimin nr.1098, datë 27.07.2019 “Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike të regjistruara si subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019”.

1.4.3 Financimi i partive politike për vitin kalendarik 2019.

Për ushtrimin e aktivitetit normal të tyre, partitë politike financohen nga buxheti i shtetit. Ligji për partitë politike ngarkon KQZ-në të përcaktojë masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore.

Ligji nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, parashikoi fondin prej 190 milionë lekësh, si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2019.

Neni 19, pika 2, e Ligjit “Për partitë politike”, i ndryshuar, përcakton rregullat sipas së cilave bëhet shpërndarja e fondeve vjetore për partitë politike:

- a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;
- b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare
- c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike, që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë



vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

1.5 PLANIFIKIMI

1.5.1 Infrastruktura për përgatitjen e logjistikës zgjedhore.

a. Infrastruktura logjistike e KQZ-së:

Hapësirat që KQZ ka në administrim për përgatitjen e logjistikës zgjedhore janë të mjaftueshme për të përballuar kërkesat në specifikë/sasi për materiale zgjedhore, si dhe përgatitjen e tyre në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor.

Rikonstruktimi i magazinës në Lundër lehtësoi në mënyrë thelbësore gjithë procesin e përgatitjes së BMZ për qendrat e votimit dhe grupet e numërimit të votave.

b. Infrastruktura për ZRZ-të, KZAZ-të dhe KQV-të:


Materialet dhe dokumentacioni bazë që përgatitet për procesin zgjedhor, kryesisht për KZAZ-të dhe KQV-të është i përcaktuar në detaje nga Kodi Zgjedhor, fakt që nuk lë hapësirë për problematikë. KZAZ-të u pajisën me dokumentacion, pajisje bazë dhe materiale zgjedhore në kohën e duhur dhe nuk pati asnjë problem për funksionimin e operativitetit të dërgimit apo marrjes së informacionit.

Në lidhje me infrastrukturën e KQV-ve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në fokus të punës së tij, pati edhe krijimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara. Për sa i përket votuesve të verbër, qendrat e votimit u siguruan me fletë votimi/maskë në alfabetin “Braille”. Gjithashtu, qendrat e votimit u pajisën me dhoma të fshehtësisë të përshtatura për të siguruar të drejtën e votës personave me aftësi të kufizuara.

1.5.2 Burimet njerëzore në KQZ.

Administrata e KQZ-së organizohet sipas strukturës dhe organigramës së detajuar të punonjësve, miratuar me Vendimin e KQZ-së Nr.168, datë 24.04.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e KQZ-së nr.110 datë 12.09.2002 ”Për miratimin e strukturës, organikën dhe numrin e punonjësve të administratës së KQZ-së”, i ndryshuar.





Bazuar në strukturën organizative aktuale institucioni ka gjithsej 71 pozicione të miratuara, 45 pozicione janë pjesë e shërbimit civil dhe pjesa e mbetur përbëhet nga punonjës mbështetës.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore synon zhvillimin e një shërbimi civil profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë, më tepër transparencë në procedurat e rekrutimit, sigurimin e një procesi të drejtë konkurimi për vendet vakante në shërbimin civil.


1. Procesi i rekrutimeve të reja në shërbimin civil:

Gjatë vitit 2019, Njësia Përgjegjëse në bazë të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ka ndjekur këto procedura;

- ✓ Procedura e “Pranimit në Shërbimin Civil”, niveli kategori ekzekutive, përkatësisht në pozicionet: specialist në DSHLZ, DBNJ dhe DTI.
- ✓ Procedura “Lëvizja paralele” në kategorinë ekzekutive, përkatësisht në pozicionet: Specialist/Jurist prokurimesh në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore si dhe Specialist Redaktor/Edukimi, në Sektorin e Edukimit të Zgjedhësve, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve;
- ✓ Procedura ”Ngritje në detyrë”, për kategorinë e mesme drejtuese, për pozicionin e punës, Drejtor i Teknologjisë së Informacionit.
- ✓ Procedura “Pezullim” në kategorinë ekzekutive, përkatësisht për pozicionin e punës: Specialist/IT në Drejtorinë e Teknologjisë së informacionit.

Në tabelën e mëposhteme paraqitet shpërndarja e emërimeve sipas llojit të procedurës.

Konkurrimet e zhvilluara gjatë vitit 2019




Gjatë një viti zgjedhor apo në periudha të tjera, KQZ rekruton edhe punonjës shtesë me kohë jo të plotë, për të kryer funksione specifike që lidhen me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në periudhën mars - prill 2019 mbi bazën e një planifikimi të nevojave për shtesë të burimeve njerëzore me vendimin nr.40, datë 26.12.2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe strukturën e pagave, të punonjësve me kohë jo të plotë pune, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019”, filloi rekrutimin e 337 punonjësve me kohë jo të plotë punë.

Punonjësit e rekrutuar I’u nënshtruan një trajnimi 2 ditor, për njohjen e procesit të punës, nga punonjësit e drejtorive përkatëse.


Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i aplikimeve në KQZ për punonjës me kohë jo të plotë pune si dhe raporti gjinor i pranimeve.



Trajnimet e Stafit

Më poshtë paraqiten në formë grafike treguesit në lidhje me numrin e nëpunësve civilë të trajnuar.

- Trajnimi i 35 nëpunësve të administratës për 15 programe trajnimi.
- E-learning – 10 nëpunës të administratës kanë përfituar shërbimin për gjuhët e huaja për një periudhë 1-vjecare për 3 gjuhë të huaja në të gjitha nivelet.




➤ **Zyra e Regjistrimit dhe Administrimit të Dokumenteve**



- Janë regjistruar 7.050 aplikime për anëtar të 90 KZAZ-ve dhe KQV-ve të shoqërisë civile për shkak të mosregjistrimit të Partive Politike të spektrit të djathtë në këto zgjedhje.

Përfaqësuesve të partive politike dhe personave të interesuar, i është vënë në dispozicion dokumentacioni administrativ i kërkuar, si; vendime për regjistrimin e partive, vendimet e listave shumemërore, për ngritjen e KZAZ-ve, VNV-ve, emërimet e anëtarëve të KZAZ-ve, etj.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat e detajuara të regjistrave të disponuar nga ZRAD të emërtuara dhe të detajuara sipas regullave të administrimit të dokumentacionit për vitin 2019:



Zbardhja e të gjithë materialeve audio të mbledhjeve të KQZ-së është përafërsisht 80 orë, të cilat konsistojnë në zbardhjen e procesverbaleve që i bashkëlidhen vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së, si dhe materiale jashtë rendit të ditës (Raporti i BMM, shpërdarje të mandateve etj).

Arkiva

Me marrjen e dokumentacionit administrativ të vitit 2018 u bë përpunimi, plotësimi, inventarizimi dhe skanimi i gjithë dokumentacionit si; vendime, shkresa, urdhërat e brendshëm etj. Janë plotësuar, numërtuar dhe skanuar të gjitha vendimet e vitit 2019.

Dokumentacioni për zgjedhjet vendore 2019 ishte mjaft voluminoz. Është përpunuar, plotësuar, inventarizuar dhe skanuar i gjithë dokumentacioni zgjedhor si; listat shumemërore të dorëzuar në KQZ nga partitë politike për kryetar dhe këshilltar bashkie, tabelat e rezultateve përfundimtare për kryetar dhe këshilltar, vendimet e emërimit të anëtarëve/kryetarëve/sekretarëve të KQV dhe GNV, që sipas afateve të përcaktuara në nenin

178, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dorëzohen në Arkivin Qendror të Shtetit.

I.5.3 Prokurimet.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në funksion të misionit për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, pjesë të rëndësishme të punës së tij ka edhe sigurimin e bazës materiale të logjistikës zgjedhore (mallra/shërbime). KQZ ka marrë të gjitha masat për kryerjen e procedurave prokuruese (procedurë e hapur, kërkesë për propozime etj.) për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, 30 Qershor 2019. Vendimmarrja e KQZ-së konsiston edhe në miratimin e modeleve dhe specifikimeve përkatëse teknike të artikujve të kërkuar.

Duke qënë se në pjesën më të madhe të tyre logjistika zgjedhore përdoret vetëm për zgjedhjet e rradhës (fletë votimi, kode sigurie, zarfa dhe procesverbale etj.), siguri i tyre kërkon zhvillimin e procedurave prokuruese.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zhvilloi 31 procedura prokurimi, prej te cilave 18 procedura ishin në funksion të zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2019.

Llojet e procedurave që u përdorën në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik janë:

- ✓ 13 procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës,
- ✓ 13 procedura prokurim me vlerë të vogël
- ✓ 3 procedura kërkesë për propozime
- ✓ 1 procedurë e hapur

Në përfundim të procedurave prokuruese me operatorët fitues u nënshkruan kontrata dhe u lëvrua malli apo shërbimi i kërkuar.

I.6 NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

I.6.1 Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore

Kodi Zgjedhor, përcakton si kompetencë të KQZ-së ngritjen e Zyrave Rajonale Zgjedhore të përhershme apo të përkohshme me qëllim zbatimin e detyrave që burojnë nga ligji zgjedhor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Zyrat Rajonale Zgjedhore shërbejnë për të vendosur një koordinim dhe komunikim më të mirë dhe më efikas midis KQZ-së dhe komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, subjekteve zgjedhore dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në funksion të mirë-administrimit të procesit zgjedhor dhe rritjes së transparencës në veprimtarinë e KQZ-së.

KQZ, me vendimin e datës 15.01.2019 vendosi ngritjen e Zyrave Rajonale Zgjedhore në 12 qarqet e vendit, të cilat do të funksiononin përgjatë periudhës 1 mars - 31 korrik 2019.

KQZ-ja, me akt normativ ka përcaktuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit, të drejtat dhe detyrimet e Zyrave Rajonale Zgjedhore, rregullat për komunikimin me të tretët. Në bazë të



përcaktimeve të aktit normativ, në vlerësim të numrit të njësisive të qeverisjes vendore, të ZAZ-ve, qendrave të votimit të përfshira në territorin e qarkut përkatës, relievit gjeografik të tij, në funksion të volumit të punës për mirë organizimin dhe mirë administrimin e procesit zgjedhor, numri i personelit të Zyrate Rajonale Zgjedhore në nëntë qarqe përbëhej nga dy inspektorë rajonalë zgjedhorë, dhe në tre qarqe nga tre inspektorë rajonalë zgjedhorë.

Ambientet për Zyrat Rajonale Zgjedhore u siguruan nga Institucioni i Prefektit. Përzgjedhja e inspektorëve rajonalë u krye bazuar në konkurimin e hapur. Vendndodhja dhe adresat e zyrave, emrat e inspektorëve dhe kontaktet e tyre u publikuan në faqen e internetit të KQZ-së.

Zyrat Rajonale Zgjedhore dhanë një ndihmesë të madhe në organizimin e punës dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme, duke kontaktuar vazhdimisht me organet e pushtetit lokal, drejtoritë e ndryshme Rajonale, Institucionin e Prefektit dhe Nënprefektit si dhe institucionet e tjera shtetërore për të cilat Kodi Zgjedhor përcakton detyra konkrete për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. E një rëndësie të veçantë evidentohet puna e Zyrate Rajonale Zgjedhore për monitorimin e punës së KZAZ-ve, koordinimin e punës së KZAZ-ve me organet e pushtetit vendor, inspektimin e ambienteve në ndërtesa private të propozuara për qendra votimi, koordinimin e punës për realizimin e trajnimeve të administratës zgjedhore, inspektimin dhe ndjekjen e përgatitjeve për përshtatjen e ambienteve dhe krijimin e kushteve për vendet e numërimit të votave, si dhe inspektime të ndryshme sipas problematikës së hasur gjatë procesit zgjedhor apo të kërkuar nga KQZ.

Në situatën që u krijua në disa Bashki, problemeve që u krijuan nga mos vënia në dispozicion të ambienteve të përcaktuara për Qendra Votimi apo Vende Numërimi të Votave, Zyrat Rajonale Zgjedhore luajtën një rol të rëndësishëm për shkëmbimin e informacionit mes KQZ-së, KZAZ-ve dhe KQV-ve, në funksion të dhënies së zgjidhjeve për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor.

1.6.2 Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve

KQZ, mori masat në kohë për krijimin e Selive të KZAZ-ve sipas përcaktimeve të nenit 93 të Kodit Zgjedhor dhe për sigurimin e kushteve optimale për kryerjen e detyrave nga ana e tyre. Me vendimin nr. 16, datë 18.01.2019, KQZ përcaktoi Bashkitë ku do të ngriheshin Selitë e KZAZ-ve, duke përcaktuar se mjetet dhe pajisjet e punës do të siguroheshin nga Kryetarët e Bashkive.

Kryetarët e Bashkive, respektuan afatin për caktimin e ambienteve ku do të ngrihej selia e KZAZ dhe dërgimin e informacionit në KQZ, por vetëm disa prej tyre siguruan mjetet dhe



pajisjet e punës. Plotësimi i të gjithë Selive të KZAZ-ve me mjetet dhe pajisjet e nevojshme të punës u monitorua dhe u ndoq me vëmendje, në vlerësim të rolit dhe rëndësisë së detyrave të KZAZ-ve, veçanërisht të KZAZ-ve që do të kryenin procedurat e regjistrimit të kandidatëve.

KQZ, me vendimet e datës 01.02.2019, në përputhje me urdhërimet e Kodit Zgjedhor për përbërjen e KZAZ-ve, përcaktoi partitë politike që do të paraqisnin propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, si dhe partitë politike që do të propozonin anëtarin e shtatë të KZAZ-ve sipas rezultatit të shortit të hedhur në seancë publike. Propozimet dhe dokumentacioni përkatës për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, duhej të paraqitej deri më datë 18 mars 2019.

Brenda këtij afati, paraqiti kandidaturat dhe dokumentacionin përkatës për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve vetëm Partia Socialiste e Shqipërisë. KQZ, pas kryerjes së verifikimeve për kandidaturat e paraqitura për plotësim të kriterëve ligjore, arsimi, vendbanimi në zonë dhe gjendja gjyqësore, masa disiplinore në proceset zgjedhore pararendëse, me vendimin e datës 02.04.2019, emëroi anëtarët dhe sekretarët të KZAZ-ve, sipas propozimeve të Partisë Socialiste të Shqipërisë:

- KZAZ-të me numër tek kishin të emëruar tre anëtarë, kishte një vakancë për plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje;
- KZAZ-të me numër çift kishte vakancë të pozicionit të sekretarit;

Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ përcaktojnë se Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ngrihet dhe funksionon kur ka në detyrë shumicën e anëtarëve të saj (katër anëtarë) dhe sekretarin. Vakancat në përbërjen e KZAZ-ve, të krijuara për shkak të mosparaqitjes së propozimeve nga partitë politike të opozitës parlamentare, pavarësisht kërkesave të përsëritura të KQZ, pamundësuan konstituimin në afat të KZAZ-ve.

KQZ, në zbatim të urdhërimeve të kuadrit ligjor, Kodi Zgjedhor neni 29, Udhëzimi nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”, publikoi për tre ditë me radhë, në shtypin e shkruar të printuar dhe në faqen zyrtare të KQZ-së, njoftimin publik për shprehje interesi nga qytetarët, ku përcaktoheshin kushtet dhe kriteret që duhet të plotësonin shtetasit e interesuar, dokumentacioni për të provuar përmbushjen e kërkesave të ligjit dhe afati për paraqitjen e tij.

KQZ, në ushtrim të kompetencës për drejtimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, rishikoi Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që



mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”, duke e plotësuar dhe ndryshuar procedurat e përzgjedhjes nga lista e shtetasve të miratuar me vendim të KQZ për emërimet kryesisht për plotësimin të vakancave në KZAZ apo KQV .

Ndryshimet e aktit nënligjor, të cilat përcaktuan se përzgjedhja e shtetasve për plotësimin të vakancave në KZAZ apo KQV, të bëhej me procedurë shorti që do të organizohej sipas rastit nga KQZ apo KZAZ, synoi rritjen e transparencën në organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor, dhe sigurinë në kryerjen e procedurave në respektim të plotë të përcaktimeve ligjore.

Në përgjigje të njoftimit publik, shprehën interes për tu emëruar kryesisht anëtarë të KZAZ, 324 shtetas, të cilët depozituan pranë KQZ-së kërkesën dhe dokumentacion përkatës. Për të gjithë aplikantët u krye verifikimi për plotësim të kriterëve ligjore, të qënjit zgjedhës, arsimit të lartë, vendbanimi në zonë, masa disiplinore në proceset zgjedhore pararendëse. Gjendja gjyqësore u verifikua pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

KQZ me vendimin nr.140, datë 9.04.2019, miratoi listën emërore të 318 shtetasve, 149 ose 46% e të cilëve ishin gra, të cilët mund të emëroheshin kryesisht për plotësim të 90 vakancave të KZAZ-ve, me qëllim ngritjen dhe funksionalitetin e tyre.

Përzgjedhja e shtetasve për plotësim të vakancës së anëtarit të KZAZ-ve me numër tek, dhe sekretarit të KZAZ-ve me numër çift, në 80 raste u krye duke zbatuar procedurat e shortit, për shkak të numrit të madh shtetasish në listën e miratuar me vendim të KQZ.

Në zbatim të nenit 29, pika 5, të Kodit Zgjedhor, nenit 9, pika 4, të Udhëzimit nr. 2, datë 25.02.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, i ndryshuar, KQZ emëroi kryesisht anëtar në 45 KZAZ-të me numër tek dhe sekretarë në 45 KZAZ me numër çift.

Pas plotësimit të vakancave përmes emërimeve kryesisht, KQZ me vendimin nr. 141, datë 09.04.2019, KQZ vendosi ngritjen e 90 KZAZ-ve dhe thirrjen e mbledhjes së parë të tyre në datat 11 dhe 12 prill 2019, proces i cili u krye në afatet e parashikuara dhe sipas planifikimit në të gjithë territorin e vendit.

Bazuar në kërkesat e Partisë Socialiste u zëvendësuan 108 ose 18% e anëtarëve të KZAZ-ve, 18 prej të cilëve kryetar dhe zvkryetar, 13 sekretarë dhe 77 anëtarë.

Nga 90 shtetas të emëruar kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancave në KZAZ, 25 prej tyre



paraqitën dorëheqjen, 9 ose 36% e tyre ishin gra. KQZ plotësoi menjëherë vakancat e krijuara për shkak të dorëheqjeve, duke përzgjedhur me procedurë shorti nga lista e shtetasve të miratuar me vendim të KQZ.

Angazhimi i komisionerëve zgjedhorë me eksperiencë të mëparshme zgjedhore u evidentua në propozimet e bëra nga Partia Socialiste, ndërsa anëtarët e emëruar kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancave përgjithësisht angazhoheshin si anëtarë të KZAZ-ve për herë të parë.

Partia Socialiste respektoi kuotën gjinore në propozimet për anëtarësinë e KZAZ-ve, në propozimet e para dhe në kërkesat për lirim-emërim të anëtarëve të KZAZ-ve.

Në konstituimin e KZAZ-ve, nga të emëruarit sipas propozimit të Partisë Socialiste 133 ose 36.9% ishin gra, dhe pas lirim/emërimeve, 132 ose 36.6% ishin gra. Partia Socialiste e Shqipërisë propozoi 360 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 133 ose 36.9 % prej tyre ishin gra, nga të cilat:

- 15 ushtruan detyrën e Kryetares së KZAZ-së;
- 10 ushtruan detyrën e Zv/Kryetares së KZAZ-së;
- 18 ushtruan detyrën e Sekretares së KZAZ-së;
- 90 ushtruan detyrën e anëtares së KZAZ-së.

Emërimet kryesisht për plotësim të vakancave të KZAZ-ve u kryen me procedurë shorti, e cila realizoi përzgjedhjen rastësore të kandidatave, në funksion të rritjes së transparencës dhe besueshmërisë publike në organizimin dhe administrimin e procesit. Në momentin e konstituimit të KZAZ-ve, nga 90 të emëruarit kryesisht për plotësim të vakancave në KZAZ, 44 ose 48% ishin gra. Pas plotësimit të vakancave të shkaktuara nga dorëheqjet e paraqitura nga shtetasit e emëruar kryesisht, 42 ose 46% ishin gra, 23 prej të cilave ushtruan detyrën e sekretares së KZAZ.

Në rang vendi, përfaqësimi i grave në KZAZ në momentin e konstituimit ishte 177 gra ose 39 %, dhe në përfundim të procesit 174 gra ose 38%.

Në datë 20.05.2019, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim paraqitën kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, dhe duke u bazuar në nenin 29, pika 5, paragrafi i dytë i Kodit Zgjedhor, kërkuan zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-ve të emëruar kryesisht nga KQZ, me anëtarët e propozuar prej tyre.

KQZ, gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë në mbledhjen publike të datës 23.05.2019, arsyetoi dhe vlerësoi se:

Neni 29, baza kryesore ligjore të cilës i referohej PD e LSI, është vetëm një nga dispozitat e Kodit Zgjedhor që rregullon mbi ngritjen dhe funksionimin e organeve të nivelit të dytë e të tretë të administrimit të zgjedhjeve, respektivisht KZAZ dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), apo edhe të Grupeve të Numërimit të Votave (GNV). Neni 29 nuk duhet parë i shkëputur dhe si një i vetëm, po duhet vlerësuar në tërësinë e Kodit Zgjedhor, në kuptimin që qëllimi i nenit 29 të jetë në përputhje edhe me vetë qëllimin e Kodit Zgjedhor, i cili nënkupton interesat, vlerat, objektivat, politikat dhe funksionet që ligji duhet të realizojë në një demokraci. Kodi Zgjedhor është në tërësinë e tij një kodifikim i së drejtës zgjedhore dhe i problematikave që kjo e drejtë ka paraparë në vite. Kodi Zgjedhor është ngritur dhe konceptuar mbi bazën e parimit të pjesëmarrjes, përfshirjes dhe balancimit të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Në kuptim të parimit të pjesëmarrjes, përfshirjes dhe balancimit të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje si dhe të qëllimit numër një të Kodit, i cili është realizimi i zgjedhjeve (dhe jo dështimi apo sabotimi i tyre), megjithëse në periudhën deri 90 ditë përpara datës së zgjedhjeve janë (vetëm) disa parti politike parlamentare ato që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ, pas kalimit të afatit “jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve” të parashikuar nga neni 64 i Kodit Zgjedhor mundësinë për të propozuar emërimet, lirimet dhe shkarkimet e tyre, i kanë vetëm partitë politike që gëzojnë njëkohësisht edhe statusin e subjekteve zgjedhore. Ligji, si esenca e arsyes, nuk mund të krijojë situata të tilla absurde kur anëtarët e KZAZ, ndërsa emërohen nga parti parlamentare të caktuara, nuk mund të zëvendësohen apo të shkarkohen më prej tyre. PD dhe LSI nuk e gëzonin statusin e subjekteve zgjedhore, pasi nuk ishin regjistruar në KQZ brenda afatit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor.

Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim duke mos u regjistruar në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019, nuk përmbushin kriterin ligjor për të qenë subjekt zgjedhor, dhe për pasojë, bazuar edhe në praktikën e Gjykatës Europiane për të drejtat e Njeriut, nuk mund të propozonin në këtë fazë të procesit zgjedhor anëtarë për KZAZ, po ashtu edhe për KQV-të dhe GNV-të.

Neni 29 është pazgjidhshmërisht i lidhur edhe me nenet 36, 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor, të cilët rregullojnë në lidhje me përbërjen e KQV dhe GNV. Leximi i nenit 29 shkëputur nga nenet e tjera të Kodit Zgjedhor do të thoshte neglizhencë e plotë ndaj qëllimit të Kodit Zgjedhor. Në respekt të interpretimit sistematik e teologjik të normativës së Kodit Zgjedhor, ashtu edhe të interpretimit logjik nga e kundërta, KQZ vlerësoi se anëtarë të KZAZ, KQV dhe GNV mund të propozojnë vetëm partitë politike të shumicës parlamentare dhe partitë e opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje.

KQZ, me vendimin nr. 657, datë 23.05.2019, vendosi rrezimin e kërkesës së paraqitur nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, subjekte politike të cilat në momentin e kërimit nuk gëzonin dy elementë shumë të rëndësishëm, qënien subjekt zgjedhor dhe cilësinë



e shumicës apo të pakicës parlamentare sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Ndaj vendimit të KQZ, ushtroi ankim në Kolegjin Zgjedhor subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë. Kolegji Zgjedhor vendosi rrëzimin e ankimit, pasi ankimuesi nuk legjitimohej në kuptim të përcaktimeve të nenit 145, pika 1, të Kodit Zgjedhor (ankimuesi nuk gëzonte statusin e subjektit zgjedhor, të cilit kjo dispozitë i njeh të drejtën e ankimit në Kolegjin Zgjedhor ndaj vendimeve të KQZ-së).

KZAZ-të përgjithësisht përmbushën detyrat e tyre me profesionalizëm, pavarësisht numrit të kufizuar të anëtarëve në detyrë, dhe situatave të cilat e vështirësuan punën e tyre në jo në pak raste.

KZAZ-të të cilat mbulonin të vetme territorin e bashkisë përkatëse, administruan dokumentacionin e kandidimit, kryen procedurat ligjore për verifikim të tij, dhe brenda afatit ligjor disponuan me vendimet përkatëse për regjistrim/mosregjistrim të kandidatëve për kryetarë të bashkive/listave shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkisë. Verifikimi nga ana e KQZ i pastërtisë së figurës së kandidatëve kushtëzonte vendimarrjen e KZAZ-së, për regjistrim/mosregjistrim të kandidatëve për kryetarë bashkie dhe listave shumemërore për këshillin e bashkisë, pavarësisht se nga ana e KZAZ ishin kryer verifikimet e dokumentacionit të kandidimit.

Veprimtaria e këtyre KZAZ-ve në këtë etapë, u monitorua me vëmendje maksimale. U ndërtua data-baze mbi bazën e informacionit të dhënë nga KZAZ-të për kërkesat e paraqitura për regjistrim të kandidatëve/listave shumemërore, dokumentacionin, si nga partitë politike ashtu edhe nga grupe nismëtare të shtetasve për rregjistrim të kandidatëve të pavarur, e cila shërbeu për koordinimin e veprimtarisë për verifikimin e dorëzimit të formularëve të vetëdeklarimit në KQZ, dhe vijimit të procedimit nga KQZ. Pavarësisht informacionit dhe qartësimeve të dhëna paraprakisht, pati raste kur KZAZ-të, si pjesë të dokumentacionit të kandidimit kishin pranuar formularët e vetëdeklarimit, të cilat duhet të dorëzoheshin në KQZ, apo raste të subjekteve që kishin dorëzuar në KQZ bashkë me formularin e vetëdeklarimit edhe dokumentacion kandidimi, i cili duhej të dorëzohej në KZAZ. Organizimi i mirë i punës, shkëmbimi i informacionit në dinamikë KQZ-KZAZ dhe anasjelljas, bëri që të gjitha këto pasaktësi të evidentoheshin dhe të veprimeve menjëherë për të dërguar dokumentacionin përkatës pranë strukturës kompetente, duke vepruar me efikasitet dhe realizuar mbarëvajtjen e kësaj etape të rëndësishme të procesit, e cila ishte sfiduese për shkak se zbatoheshin për herë të parë, volum të madh dokumentacioni për t'u administruar, përpunuar dhe disponuar me vendimarrje në një kohë të shkurtër.

Vendimet e KQZ për njoftimin e KZAZ-ve për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatëve për kryetar të bashkisë/ listave shumemërore për këshillin bashkiak, të marra pas



verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i’u përcollën menjëherë KZAZ-ve.

KZAZ-të kryen me korrektësi dhe në afat procedurat e pranimit të dokumentacionit të kandidimit, të verifikimit, kthimit për korigjim, ripranimit të tij, dhe morrën 413 vendime për regjistrimin e listave shumëmemërore dhe 78 vendime për regjistrimin e kandidatëve për kryetarë bashkie.

Shkëmbimi i informacionit, dhënia e asistencës, trajnimi i komisionerëve nga ana e KQZ-së, dha impakt në profesionalizmin e anëtarëve të KZAZ-ve, në kryerjen e detyrave në respektim korrekt të procedurave dhe afateve ligjore. Testimi i njohurive në përfundim të trajnimit dëshmoi për nivel shumë të mirë të kuptimit të ligjit zgjedhor, të detyrave, përgjegjësisë dhe procedurave të KZAZ-ve për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në zonën e administrimit zgjedhor.

Kërkesat e datave 13-14 qershor 2019, nga Kryetarët e Bashkive Mat, Kamëz, Kavajë, Gjirokastrë, Dropull, Përmet, Delvinë, Shkodër, Tropojë, Kukës, Vau i Dejës, Lezhë, Klos, Vorë, Kavajë, Cërrik, Rrogozhinë, Mallakastër, Kuçovë, Berat, Skrapar, Pogradec, Peqin dhe Përrenjas, për lirim të menjëhershëm të ambienteve ku ishin vendosur selitë e KZAZ-ve dhe Vendet e Numërimit të Votave, si edhe për ndërprerjen e veprimeve për afishimin e listave të zgjedhësve ose heqjen tyre nga ambientet e shkollave në administrim të bashkive, u vlerësuan nga KQZ si veprime në shkelje flagrante të dispozitave të Kodit Zgjedhor, parimeve të përgjithshme të tij, të cilat cënonin zhvillimin e procesit zgjedhor.

Kryetarëve të Bashkive që me qëndrime, kërkesa apo veprime, po krijojnë pengesa në organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor, KQZ përmes komunikimit shkresor i qartësoi për shkeljet ligjore që po kryenin, dhe përgjegjësitë penale me të cilat i ngarkonin qëndrimet/veprimet e ndërmarra, duke referuar Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 5.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, përmes së cilës:

- kërkohej që KQZ të mbrojë pacënueshmërinë si dhe të garantojë vazhdimësinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019, në zbatim të dekretit të Presidentit nr. 10 928, datë 5.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” ;
- i bëhej thirrje të gjitha organeve publike, që ngarkohen nga ligji me detyra në kuadër të mbarëvajtjes dhe organizimit të zgjedhjeve vendore të datës 30 qershor 2019, të vijojnë përmbushjen e detyrave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës për të



garantuar të drejtën kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor.

KQZ, menjëherë e ndau edhe me opinionin publik shqetësimin për situatën e krijuar. Përmes deklaratës publike të datës 14 qershor 2019, i bëri thirrje dhe kërkoi reflektimin të menjëhershëm nga ana e Kryetarëve të Bashkive që kishin paraqitur kërkesa të tilla apo kishin ndërmarrë veprime, për të mos penguar apo cënuar punën e KZAZ-ve në përmbushje të përgjegjësisë dhe detyrave të tyre për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor të datës 30 qershor 2019. KQZ, në përmbushje të rolit dhe misionit institucional, paralajmëroi se në rast të mosreflektimit pas këtij komunikimi, vijimit të qëndrimeve apo veprimeve në cënim të punës për administrimin e procesit zgjedhor të datës 30 qershor 2019, do të ndërmerre veprimet ligjore për të shmangur çdo pengesë apo qëndrim që do të tentonte të cënonte mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të datës 30 qershor 2019.

Veprime të dhunshme në Selitë e disa KZAZ-ve me pasoja dëmtimin apo edhe asgjësimin e materialeve zgjedhore, në disa raste edhe në kohën kur komisionerët ishin në detyrë, tensionuan situatën. Në të gjitha këto raste, komisionerët me qetësi dhe përgjegjshmëri të lartë vijuan përmbushjen e detyrave duke shmangur situatat konfliktuale. KQZ mori masat dhe pajisi KZAZ-të me materiale zgjedhore të cilat u dëmtuan, dhe caktoi 11 Vende të Numërimit të Votave në ambiente të tjera, në vlerësim të situatës, problematikave dhe propozimeve të paraqitura nga Prefektët e Qarqeve. Ambientet e reja ku u caktuan 11 VNV-të, përmbushnin kriteret ligjore sa i përket vendndodhjes, sipërfaqes dhe lehtësisë logjistike të transportit rrugor. Në të gjithë këto ambiente, u instalua teknologjia mbështetëse për numërimin e votave, pavarësisht vështirësive që shkatoi koha e shkurtër në dispozicion.

I.6.3 Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore u ngritën 5417 Komisione të Qendrave të Votimit, u emëruan 21.668 anëtarë të Komisioneve të Qendrave të Votimit, nga të cilët 4.085 ose 19% ishin gra, dhe 17.583 ose 81% ishin burra.

Në respektim të afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, KZAZ-të duhej të emëronin anëtarët, kryetarët dhe sekretarët e KQV-ve brenda datës 10.06.2019, dhe në çdo rast jo më vonë se data 15.06.2019. Partia Socialiste e Shqipërisë, i vetmi subjekt zgjedhor që gëzonte të drejtën të paraqiste propozimet për anëtarë të KQV, respektoi afatin dhe paraqiti kandidaturat dhe dokumentacionin përkatës.



Partia Demokratike, pavarësisht se nuk mund të propozonte anëtarë të KQV-ve sipas vendimit të KQZ-së lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor, përmes degëve lokale paraqiti pranë disa KZAZ-ve propozimet për anëtarë të KQV-ve. KZAZ-të administrojnë kërkesat dhe dokumentacionin dhe disponuan me vendim mospranimin e tyre, bazuar në nenin 33 dhe 36 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin e KQZ-së nr. 657, datë 23.05.2019.

KQZ në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”, i ndryshuar, publikoi në gazeta dhe faqen zyrtare në internet njoftimin për shprehje interesi nga shtetas për të ushtruar detyrën e anëtarit të KQV-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, kushtet që duhej të përmbushnin të interesuarit, dokumentacionin që duhej paraqitur dhe afatin e aplikimit.

Pas emërimeve të anëtarëve të KQV-ve, sipas propozimeve të Partisë Socialiste, për 2.078 KQV që kishin në detyrë vetëm tre anëtarë, konstatohej vakancë për plotësimin e kuorumit prej katër anëtarësh për vendimmarrje. Në rang vendi, vakanca e një anëtari në 2.078 KQV do të plotësohej nga KZAZ respektive përmes emërimeve kryesisht.

Në përgjigje të njoftimit publik, aplikuan pranë KQZ-së, duke paraqitur kërkesë të shoqëruar me dokumentacion, 6.672 shtetas për t’u emëruar kryesisht anëtarë të KQV. Për të gjithë kandidaturat u krye verifikimi i plotësimin të kriterëve ligjore: të ishin zgjedhës, vendbanimi, arsimit, mos pasja e masave disiplinore në procese të mëparshme zgjedhore, ndërkohë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve u verifikua gjendja gjyqësore. Nga 6.700 shtetas që kishin aplikuar, pas verifikimit të gjendjes gjyqësore, 108 prej tyre rezultuan të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

KQZ, për çdo zonë zgjedhore, miratoi me vendim listën emërore të shtetasve të cilët mund të emëroheshin kryesisht anëtarë të KQV-ve. Vendimet e KQZ-së së bashku me listën emërore të shtetasve, i’u dërguan menjëherë KZAZ-ve përkatëse. KZAZ-të plotësuan vakancat në ato KQV të cilat kishin një anëtar më pak se kuorumi i kërkuar ligjor për vendimmarrje. Plotësimi i vakancave nga KZAZ-të u krye në zbatim të procedurave të Udhëzimit të KQZ nr. 4, datë 19.02.2013, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”, i ndryshuar.

Volumi i madh të punës për administrimin e aplikimeve të 6.700 shtetasve, kryerjes së verifikimeve për përmbushjen e kushteve ligjore të secilit nga aplikantët, shkëmbimi i



informacionit me Drejtorinë e Burgjeve, miratimit i listave emërore mbi bazë zone zgjedhore dhe zone të administrimit zgjedhor, konsumoi kohë fizike. Megjithatë, falë përkushtimit dhe angazhimit maksimal të dëshmuar, u arrit që KZAZ-të përgjithësisht të kryenin brenda afateve ligjore plotësimin e vakancave të 2.078 KQV-ve përmes emërimeve kryesisht.

Realizimi i programit të trajnimit të KQV, u cënua në disa Bashki nga mos lejimi i shfrytëzimit të ambjenteve të shkollave për këtë qëllim.

KQV-të në të gjithë vendin kishin në detyrë numrin e nevojshëm të anëtarëve për vendimarrje, dhe përgjithësisht kryen me korrektësi procedurat gjatë ditës së votimit, respektuan orarin e hapjes dhe mbylljes së qendrave të votimit. Fakti se asnjë kuti votimi apo kuti e materialeve zgjedhore nuk u deklaruan të parregullta nga ana e grupeve të marrjes në dorëzim në VNV, dëshmon për zbatimin me korrektesë të procedurave në mbyllje të votimit nga komisionerët e KQV-ve.

1.6.4. Ngritja dhe funksionimi i GNV-ve.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, u ngritën 880 Grupe të Numërimit të Votave, u emëruan 3.520 anëtarë të Grupeve të Numërimit të Votave, 2.935 ose 83% ishin burra, 585 ose 17 % ishin gra.

Bazuar në përcaktimet e Kodit Zgjedhor, KZAZ 10 ditë para ditës së zgjedhjeve cakton grupet e numërimit të votave, të cilët përbëhen nga katër anëtarë. Bazuar në përcaktimet e Kodit Zgjedhor, GNV mund të funksionojë me dy anëtarë, përcaktim i disiplinuar nga KQZ me udhëzim të veçantë, (Udhëzimi nr. 5, datë 22.04.2015 “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave”), ku ndër të tjera në nenin 3/5 të këtij udhëzimi përcaktohet se: “Në rast se grupi i numërimit të votave funksionon me 2 anëtarë sipas përcaktimit të nenit 95/3 të Kodit Zgjedhor, detyrimisht procesi i numërimit të votave duhet të jetë i regjistruar me kamerat e teknologjisë mbështetëse të instaluar në ambjentet e VNV-së. Në rast se regjistrimi me kamera nuk funksionon për çfarëdo arsye, procesi ndërpritet deri në vënien në funksionim të teknologjisë mbështetëse, ose plotësimin e grupit të numërimit”. Nisur nga ky rregullim, KQZ-ja duke evidentuar faktin se në kushtet aktuale, GNV-ja do të ketë në çdo rast vetëm dy anëtarë, për të shmangur ndërprerjet e procesit në rast të mosfunksionimit të mjeteve të teknologjisë, referuar nenit 3 të udhëzimit nr.5, datë 22.04.2015, të sipërcituar, vlerësoi se KZAZ-ja mund të plotësojë grupin e numërimit të votave me dy anëtarë të tjerë. Vlerësimi i kontekstit aktual në përputhje me udhëzimet e miratuara në zbatim të Kodit Zgjedhor, të cilat zbërthejnë Kodin në nivelin më të pranueshëm të zbatueshmërisë, ishte me rëndësi për mirë organizmin dhe mbarëvajtjen e numërimit të votave në zgjedhjet e datës 30.06.2019. KQZ vendosi që KZAZ-ja,



në mbështetje të nenit 95 të Kodit Zgjedhor, të caktojë dy anëtarë e tjerë të GNV, duke përzgjedhur me short midis anëtarëve të KQV-së të emëruar kryesisht.

Shtetasit e emëruar kryesisht nga KZAZ, anëtarë të GNV-ve morën pjesë në trajnimin e organizuar nga KQZ.

Nuk pati asnjë rast që ndonjë komision i nivelit të dytë apo të tretë të ishte jofunksional për shkak të mungesës së kuorumit, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër kohe. Kjo dëshmon për efikasitetin e punës së KQZ, sa i përket plotësimit të kuadrit nënligjor, mënyrës së organizimit të punës, dinamikës në shkëmbimin e informacionit me administratën zgjedhore të niveleve të ulëta, ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të procedurave për plotësimin e vakancave përmes emërimeve kryesisht, të cilat garantuan ngritjen dhe funksionalitetin me profesionalizëm të administratës zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, megjithë braktisjen e sistemit nga partitë politike të opozitës.

1.7. Trajnimi i administratës zgjedhore.

KQZ me vendimin nr. 17, datë 01.02.2019, miratoi strategjinë e trajnimit të administratës zgjedhore për zgjedhjet vendore 2019, përmes së cilës për çdo nivel të administratës zgjedhore u planifikua:

- numri i kurseve/sesioneve të trajnimit;
- metodologjia dhe materialet didaktike/mjetet që do të përdoren;
- numri i trajnerëve dhe kalendari i trajnimeve, duke parashikuar edhe zgjidhje për situata të emërimeve të vonuara, lirim/emërimeve pas trajnimit.

KQZ miratoi manualin e trajnimit:

- ✓ Manualin e trajnimit për KZAZ-të (dhe fletore përkatëse të punës) pjesa e parë dhe e dytë;
- ✓ Manualin e trajnimit për KQV-të (manual dhe fletore pune, si dhe Udhëzues praktik për anëtarët e KQV-së);
- ✓ Manualin për KZAZ dhe GNV-të për procesin e numërimit të Votave,

të cilët qartësuan procedurat duke ndërthurur përcaktimet e Kodit Zgjedhor me aktet normative të miratuara nga KQZ.

Kurrikulat dhe metodologjia që KQZ miratoi dhe realizoi për të gjitha programet e trajnimit për zgjedhjet vendore 2019, u përgatitën mbështetur në eksperiencën e fituar në vite, me synimin për t'i transmetuar në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme konceptet ligjore, shoqëruar me ilustrime praktike.

Në këto zgjedhje, për 51 KZAZ-të që mbulonin të vetme territorin e njësisë së qeverisjes vendore, vëmendje e veçantë i'u kushtua trajtimit të procedurave për regjistrimin e kandidatëve,



afateve dhe dokumentacionit të kandidimit. Dokumentet e kandidimit, modelet e dokumentacionit, procedurat dhe afatet, u pasqyruan edhe në Manualin dhe Fletoren e punës së KZAZ-së, pjesa e parë.

Për komisioneret e KQV-ve, krahas Manualit të trajnimit u hartua edhe “Udhëzuesi praktik për detyrat e anëtarëve të KQV-së” si material didaktik, në format xhepi, lehtësisht i përdorshëm gjatë ditës së votimit. Ky udhëzues shërbente si kujtesë për kryerjen në kohën e caktuar dhe me korrektësi të procedurave nga kryetari, sekretari, dhe anëtarët e KQV-së, të grupuara në seksione të veçanta sipas pozicionit të tyre.

Manuali i KZAZ-së dhe GNV-së qartësonte procedurat gjatë procesit të numërimit të votave, vlerësimit të tyre, tabelimin dhe transmetimin e rezultateve. Vëmendje e veçantë i’u kushtua qartësimin të procedurave të administrimit, numërimit, vlerësimit dhe tabelimit të fletëve të votimit të hedhura gabim.

Për të gjitha programet e trajnimit, u përgatitën dhe u shpërndanë gjithashtu prezantime me poëerpoint, fleep-chartë dhe video trajnimi për KQV-të. Manualet e trajnimit ishin gjithashtu të disponueshme edhe në faqen e internetit të KQZ-së, si një mundësi alternative për përdorim nga komisionerët zgjedhorë të çdo niveli për rritjen e profesionalizmit të tyre.

1.7.1 Zhvillimi i procedurave të përzgjedhjes së kandidaturave të trajnerëve.

Për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale për realizimin e kurseve dhe sesioneve të trajnimit për të gjithë administratën zgjedhore, u përzgjedhën trajnues nga të gjithë qarqet mbi bazën e një konkurimi të hapur dhe transparent. Në përgjigje të njoftimit publik në datat 19 dhe 20 Shkurt 2019, në faqen zyrtare të KQZ-së, dhe në shtypin e shkruar, aplikuan për t’u angazhuar si trajnues 214 shtetas, nga të cilët 149 trajnues të KQZ-së në proceset zgjedhore pararendëse.

Duke vlerësuar rëndësinë e profesionalizmit të trajnuesve, si dhe në zgjedhjet e mëparshme, shpërndarja e materialeve të trajnimit u bë me email përpara realizimit të kurseve të trajnimit të tyre. Ky fakt, si dhe eksperiencia e mëparshme e shumicës së trajnuesve, rriti efektivitetin dhe cilësinë e kurseve të trajnimit. Trajnimi i trajnuesve, të njohur paraprakisht me materialet e shkruara, fokusoi anën praktike të kryerjes së procedurave, problematikave të mundshme që mund të krijohen gjatë procesit të zgjedhjeve dhe mënyrën sesi Kodi Zgjedhor u jep zgjidhje këtyre problematikave.

Trajnuesit e KZAZ-ve KQV-ve dhe GNV-ve, pas trajnimit dhe testimit të njohurive, realizuan trajnimin e komisionerëve të niveleve të dyta dhe të treat, sipas skemave me shtrirje gjeografike në të gjithë vendin, për të siguruar ofrimin e trajnimit pranë çdo komisioneri zgjedhor.

Grafikët më poshtë japin të dhëna për trajnuesit e angazhuar për trajnimin e KZAZ-ve, KQV-




ve, dhe GNV-ve, në vështrim të krahasuar me proceset zgjedhore pararendëse.


Të dhëna për trajnerë të KZAZ-ve:

| | Zgjedhje 2017 | Zgjedhje 2019 |
|-----------------------|------------------|------------------|
| Eksperiencë Zgjedhore | 75% | 91% |
| Jurist | 35% | 33.30% |
| Mësues | 48% | 53.70% |
| Të Ndryshëm | 17% | 13.00% |
| Femra | 43% | 48.10% |
| Meshkuj | 57% | 51.90% |

Të dhëna për trajnerë të KQV-ve:



| | Zgjedhje 2017 | Zgjedhje 2019 |
|-----------------------|------------------|------------------|
| EKSPERIENCË ZGJEDHORE | 66% | 75.15% |
| JURIST | 26% | 19.70% |
| MËSUES | 45% | 53.90% |
| TË NDRYSHËM | 29% | 26.40% |
| FEMRA | 43% | 55.61% |
| MESHKUJ | 57% | 44.40% |



Të dhëna për trajnerë të GNV:

| | Zgjedhje 2017 | Zgjedhje 2019 |
|-----------------------|------------------|------------------|
| EKSPERIENCË ZGJEDHORE | 61% | 86.62% |
| JURIST | 40% | 25.60% |
| MËSUES | 46% | 53.30% |
| TË NDRYSHËM | 14% | 21.10% |
| FEMRA | 42% | 55.10% |
| MESHKUJ | 58% | 48.90% |



1.7.2 Zhvillimi i trajnimeve.

Në zbatim të strategjisë së trajnimit, 54 trajnuesit e angazhuar për trajnimin e 90-të KZAZ-ve, realizuan:

- Programin e parë të trajnimit dhe testimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve më datë 8 dhe/ose 9 maj 2019;
- Programin e dytë të trajnimit të KZAZ-ve më datë 20 dhe/ose 21 maj 2019.

Programi i trajnimit të anëtarëve të KQV-ve, u zhvillua sipas kalendarit të trajnimeve në periudhën 22-27 qershor 2019, në sesione trajnimi një ditore sipas skemës së planifikuar.

Gjatë shpërndarjes së bazës materiale zgjedhore, u realizuan edhe trajnime për komisionerët që nuk kishin marrë pjesë në sesionet e zhvilluara sipas planifikimit.

Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve u realizua në ambientet e shkollave, dhe në Bashkitë ku u krijuan pengesa për përdorimin e ambienteve të shkollave, në ambiente alternative apo edhe në mjedise të hapura.

Numri i trajnuesve që u angazhuan për trajnimin e KQV-ve, nuk referoi planifikimin sipas strategjisë së trajnimit. Në vlerësim të faktit se KQV-të funksionuan me katër anëtarë, nga 280 trajnues të planifikuar, u angazhuan 170 trajnerë.

Programi i trajnimit për anëtarët e GNV-ve u realizua nga 90 trajnues, në Vendet e Numërimit të Votave. Në sesionet e planifikuara pjesëmarrja nuk ishte e plotë, por përmes sesioneve të zhvilluara përpara fillimit të procesit të numërimit të votave, u arrit që të gjithë numëruesit të marrin trajnim.

Në sesionet e trajnimit të KZAZ-ve dhe KQV-ve vëmendje i'u kushtua trajtimit të temave për garantimin e fshehtësisë së votimit (ndalimi i votimit familjar dhe në grup, rastet e fotografimit të votes), ndalimi i votimit më shumë se një herë, zgjedhësit që për arsye fizike nuk mund të votojnë vetë, etj, të cilat u demonstruan përmes simulimeve.

Trajnimi u vlerësua pozitiv nga komisionerët, referuar të dhënave të formave të vlerësimit, sa i përket materialeve didaktike, po ashtu edhe performancës së trajnerëve të angazhuar.

TË DHËNA PËR PJESËMARRJE NË TRAJNIM:

Programi I-rë i trajnimit të KZAZ-ve:



| Të trajnuar | | PS | | Emëruarkryesisht | | Kryetar | | Sekretar | |
|-------------|-------|----------|-------|------------------|-------|----------|-------|----------|-------|
| Gjithsej | Femra | Gjithsej | Femra | Gjithsej | Femra | Gjithsej | Femra | Gjithsej | Femra |
| 391 | 179 | 362 | 132 | 88 | 44 | 45 | 26 | 90 | 41 |

Programi II-të i trajnimit të KZAZ-ve:

| Të trajnuar | | PS | | Emëruar kryesisht | | Kryetar | | Sekretar | |
|-------------|-------|----------|-------|-------------------|-------|----------|-------|----------|-------|
| Gjithsej | Femra | Gjithsej | Femra | Gjithsej | Femra | Gjithsej | Femra | Gjithsej | Femra |
| 406 | 169 | 355 | 128 | 83 | 42 | 90 | 25 | 88 | 40 |

Pjesëmarrja në trajnimin e KQV-ve:

| TOTALI | GRA | PS | Kryesisht | Kryetar | Sekretar | Eksperienca |
|----------------------|------|------|-----------|---------|----------|-------------|
| 21 668 ose 56.80% | 3136 | 8982 | 1782 | 2754 | 2377 | 6568 |

| | Qarku | Pjesëmarrja në % |
|----------------|-------------|------------------|
| Në rang qarku: | Shkodër | 65% |
| | Kukës | 47.30% |
| | Lezhë | 51.40% |
| | Dibër | 64.40% |
| | Durrës | 47.80% |
| | Tiranë | 63.80% |
| | Elbasan | 49.90% |
| | Fier | 47.40% |
| | Berat | 62% |
| | Korçë | 69.10% |
| | Gjirokastrë | 60.20% |
| | Vlorë | 42% |

Pjesëmarrja në trajnimin e GNV-ve:

| Total | PS | Emëruar Kryesisht | Numëruesi Parë | Sekretar | Gra | Eksperienca |
|--------------|------|-------------------|----------------|----------|-----|-------------|
| 2260 ose 65% | 1187 | 683 | 525 | 488 | 510 | 987 |

1.8. INFORMIMI

1.8.1 Edukimi i votuesve

KQZ përmes miratimit të strategjisë për edukimin zgjedhor të shtetasve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019, në analizë të nevojave për informim dhe sensibilizim të shtetasve dhe specifikave të grupimeve me nevoja të veçanta, përcaktoi projektet e përgjithshme dhe ato specifike, metodologjinë, mjetet dhe kohën për realizimin e tyre. Projektet synonin shpërndarjen e informacionit të plotë për procesin zgjedhor, ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e të gjithë zgjedhësve për pjesëmarrje në votime.

“VOTONI! Është e drejta juaj të zgjidhni!”, ishte slogani që KQZ-ja përdori në fushatën edukuese për zgjedhjet e datës 30 qershor 2019, si një mesazh sensibilizues për çdo votues.

Realizimi i harmonizuar i programeve të ndryshme edukuese, informuese dhe sensibilizuese, gjetja e drejtimeve, formave e mjeteve sa më eficiente të komunikimit me votuesit, synoi realizimin e objektivave strategjike të mëposhtëm:

- Shpërndarjen e informacionit të plotë për procesin zgjedhor;
- Informimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve për rëndësinë e ushtrimit të së drejtës së votës në mënyrë të lirë, të fshehtë dhe të pandikuar;
- Informimin e zgjedhësve si për veprat penale që çenojnë votën e lirë dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;
- Ndërgjegjësimin e zgjedhësve për të drejtat dhe detyrimet e tyre në procesin zgjedhor;
- Realizimin apo përshtatjen e programeve edukuese, ndërgjegjësuere, sensibilizuese dhe informuese për grupime specifike shoqërore si votues për herë të parë, gra dhe vajza, persona me aftësi të kufizuara, etj.;
- Rritjen e besimit të votuesve tek administrimi i procesit zgjedhor në mënyrë të paanshme dhe të pandikuar;
- Rritjen e pjesëmarrjes në votime.

KQZ realizoi dhe transmetoi:

Pesë spote televizive:

1. Spot informues/ndërgjegjësuere për veprat penale në zgjedhje;
2. Spot informues/edukues për procedurat e votimit;
3. Spot informues/ndërgjegjësuere për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje;
4. Spot informues/ndërgjegjësuere për personat me aftësi të kufizuara;
5. Spot sensibilizues/ndërgjegjësuere për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje.

Tre spote radiofonike:

1. Spot informues/ndërgjegjësuere për veprat penale në zgjedhje;



2. Spot informues/edukues për procedurat e votimit;
3. Spot sensibilizues/ndërgjegjësues për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje.

KQZ, me qëllim realizimin e një fushate të plotë edukuese, informuese, ndërgjegjësuese për procesin zgjedhor të datës 30 qershor 2019, me vendimin nr. 642, datë 23.05.2019 miratoi caktimin e mediave dhe planin e transmetimit të spoteve televizive dhe radiofonike në televizione dhe radio.

Fushata e KQZ-së për edukimin zgjedhor të shtetasve në mediat televizive u realizua në televizionet me mbulimin më të madh të territorit, media-plan i transmetimit përcaktoi fashat orare më të ndjekura duke i'u referuar matësit të shikueshmërisë (telemetrix).

Në media plan u përfshinë 9 (nëntë) televizione, katër TV me programacion të përgjithshëm dhe pesë TV informative, 8 (tetë) televizione lokale, dhe 14 portale.

Spoti informues/ndërgjegjësues për veprat penale në zgjedhje u transmetua 792 herë në fashat orare më të ndjekura:

- 640 herë para/pas edicioneve informative (302 transmetime në televizionet me programacion të përgjithshëm dhe 338 transmetime në televizionet informative),
- 152 herë para emisioneve të mbrëmjes (77 transmetime në televizionet me programacion të përgjithshëm dhe 75 transmetime në televizionet informative).

Katër (4) spotet: sensibilizues/ndërgjegjësues për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje informues/edukues për procedurat e votimit; informues/ndërgjegjësues për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje; informues/ndërgjegjësues për personat me aftësi të kufizuara; u transmetuan 161 herë përgjatë muajit qershor, në mënyrë të alternuar para/pas emisioneve të paradites dhe pasdites me audiencë të lartë nga grupet e synuara.

Në tetë (8) media lokale të Bashkive Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Sarandë, Berat, Gjirokastrë, Elbasan, u realizuan 2.850 transmetime të pesë (5) spoteve televizive. Përzgjedhja e mediave lokale u bazua në zonën e mbulimit, shikueshmërinë dhe tarifën e ofruara.

Transmetimi i pesë (5) spoteve u realizua përgjatë muajit qershor edhe në 14 (katërmëdhjetë) portale me informacion të përgjithshëm dhe informative.

Të gjithë spotet televizive ishin të përshtatur me gjuhën e shenjave për të siguruar aksesin në informacion të zgjedhësve që nuk dëgjojnë. Nevojat specifike të zgjedhësve me aftësi të kufizuara për tu informuar për procedurat që ndjek ky grupim në votim, si dhe mesazhi sensibilizues i KQZ për të marrë pjesë në votime, u trajtuan përmes spotit të veçantë televiziv. Si pjesë e projekteve specifike për edukimin zgjedhor të zgjedhësve gra, spoti i veçantë televiziv adresoi mesazhe sensibilizuese për zgjedhëset gra të të gjitha moshave dhe



profesioneve, të zonave rurale dhe ato shtëpiake, për pjesëmarrje në votime dhe ushtrimin e të drejtës së votës në mënyrë vetjake dhe të pandikuar nga vullneti i anëtarëve të tjerë të familjes.

Tre (3) spotet radiofonike u transmetuan të alternuar 160 herë përgjatë muajit qershor në dy radio kombëtare, përzgjedhur duke u bazuar në audiencën e tyre.

Postera të ndryshëm u afishuan në ambientet zgjedhore dhe hyrjet pranë tyre (Zyrat Rajonale Zgjedhore, selitë e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor dhe në çdo qendër e votimi). Përmes tyre u synua:

- sensibilizimi i zgjedhësve për pjesëmarrje në votime. Realizimi në katër koncepte grafike për qasje ndaj zgjedhësve të rinj, grave, të moshuarve, dhe personave me aftësi ndryshe, dha në mënyrë të përshtatur mesazhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votime dhe pasqyrim të dispozitave për veprat penale që çënojnë votën e lirë dhe demokratike dhe masën e dënimit për to.
- edukimi për veprimet e zgjedhësit në qendrën e votimit, edhe përmes pasqyrimin grafik procedurave;
- informues për çfarë ndalohet në qendrën e votimit, rastet kur zgjedhesi e humb të drejtën e votimit;
- ndërgjegjësues, për sanksionet për komisionerët zgjedhorë në rast të moszbatimit të ligjit.

Posterat u publikuan në mënyrë të alternuar në 6 gazeta, si një nga mjetet efikas për komunikim me zgjedhësit. Në gazetatat e përzgjedhura, bazuar në numrin e tirazhit dhe të shpërndarjes në të gjithë territorin e vendit, u realizuan 120 publikime të alternuara të posterave me mesazheve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese për pjesëmarrje në votime për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Postera të mëdhenj (bill-board) në rrugët kryesore nacionale dhe reklamat e ndriçuara (city-lights) në qytetet kryesore, përmes logos dhe slloganit të zgjedhjeve, dhanë informacion për procesin zgjedhor duke synuar sensibilizimin e zgjedhësve për pjesëmarrje në votime në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

KQZ prodhoi fletëpalosje në format xhëp A4 dhe në format A3, me informacion për sistemin zgjedhor, të drejtat dhe detyrat e zgjedhësit në proces, dhe ilustrim grafik të procedurave të votimit. Fletëpalosjet u shpërndanë në të gjithë pikat e kalimit kufitar, për informimin e shtetasve shqiptarë me vendbanim jashtë vendit, si edhe nga KZAZ-të për zgjedhësit e rregjistruar në QV- të e zonës. Materiale të ndryshme promovionale si bluza, kapele, stilolapsa,



stema, me logon dhe slloganin e zgjedhjeve, logon dhe adresën elektronike të KQZ -së u shpërndanë për zgjedhësit edhe në sesionet e edukimit të organizuara nga KQZ.

Votuesit për herë të parë

Si praktikë e konsoliduar në disa procese zgjedhore, KQZ në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Politike dhe Ministrinë e Arsimit, zbatoi programin ndërgjegjësues dhe informues për maturantët, votues për herë të parë, në 385 shkolla e mesme në të gjithë vendin. Programi u zbatua përgjatë muajit qershor 2019 dhe adresoi 35.000 nxënës të shkollave të mesme - votues për herë të parë. Projekti i edukimit zgjedhor me votuesit për herë të parë, fokusoi në veçanti rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje, si e drejtë kushtetuese por edhe si detyrim qytetar për shoqërinë dhe të ardhmen europiane të vendit, në kontekst të tematikave që trajtojnë çështje të demokracisë funksionale, forcën e votës të lirë dhe demokratike, si dhe njohjen e procedurave korrekte të votimit.

KQZ, në Ditën Botërore të Zgjedhjeve, sikundër tashmë është kthyer në traditë, hapi dyert e institucionit për të rinjtë, për t'i njohur ata me punën për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, por edhe për të bashkëbiseduar për procesin zgjedhor, rëndësinë dhe vlerën e votës për demokracinë dhe të ardhmen europiane të vendit.

Mbi 200 maturantë dhe 70 studentë vizituan institucionin në këtë ditë, dhe morën pjesë në sesionet e edukimit zgjedhor, ku temat e trajtuara synonin informimin e të rinjve për procesin zgjedhor të 30 qershorit, të drejtat dhe detyrat e zgjedhësit në proces, në aspektin ligjor dhe praktik, për veprat penale që cenojnë votën e lirë dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Anëtarët dhe administrata e KQZ-së, në bashkëbisedim me të rinjtë vunë theksin tek rëndësia e pjesëmarrjes në votime, si dëshmi e qytetarit aktiv dhe të përgjegjshëm për të ardhmen europiane të vendit. Për maturantët u organizua simulimi i procesit të votimit, ku ata të angazhuar si komisionerë, votues, vëzhgues, dhe përfaqësues të medias, u familjarizuan me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve në proces, dhe procedurat e votimit. Konkursi i organizuar për studentët “Sa jam i informuar për zgjedhjet”, dëshmoi interesin dhe vlerësimin e të rinjve për rëndësinë e zgjedhjeve demokratike, vetëdijen e tyre për t'u bërë pjesë e fateve të vendit me votën e lirë dhe të pandikuar. Fletëpalosjet për veprat penale në zgjedhje, ofruan për të rinjtë informacion të plotë për veprimet përmes të cilave realizohet vepra penale në zgjedhje dhe masën e dënimit për to. Veprimtaritë u përmbyllën me apelin për të marrë pjesë dhe votuar menjëherisht në zgjedhjet e 30 qershorit, duke u mire informuar, zgjedhur në mënyrë vetjake, dhe denoncuar çdo veprim që synon të cenojë votën e lirë.



KQZ në vlerësim të forcimit të kulturës zgjedhore tek të rinjtë, mbështeti me logjistikë zgjedhore dhe ekspertizë, zgjedhjet në shkolla dhe struktura të tjera rinore. Ndër to, më i spikaturi ishte zgjedhja e Parlamentit Rinor Fier, strukturë përfaqësuese e nxënësve të shkollave të mesme të Qarkut Fier prej 13 vjetësh. KQZ, ka mbështetur zhvillimin e këtij procesi edhe përmes sesioneve të edukimit zgjedhor të zhvilluara në fazën përgatitore të tij, ku angazhimi i nxënësve u vendos në kontekst të angazhimit qytetar për zgjedhjet vendore 2019, duke fokusuar rëndësinë e pjesëmarrjes në votime, rëndësinë e votës si shprehje e vullnetit të lirë dhe të pandikuar për demokracinë dhe të ardhmen evropiane të vendit, ndërgjegjësimin për veprat penale që çenojnë votën e lirë, veçanërisht cënimin e fshehtësisë së votës përmes fotografimit dhe shfaqjes në rrjete sociale. Përmes simulimit të procesit të votimit, në fund të sesioneve, nxënësit njohën dhe praktikuan procedurat e votimit. Në këto sesione morrën pjesë 6 400 nxënës të 18 shkollave të mesme të Qarkut Fier, shumica e të cilëve do të ishin votues për herë të parë në zgjedhjet e 30 qershorit 2019.

Pakicat kombëtare

Në Strategjinë që KQZ miratoi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet vendore 2019, përmes një projekti të veçantë u përcaktuan mënyrat dhe mjetet që do të përdreshin për informimin dhe edukimin e pakicave kombëtare për procesin zgjedhor edhe në gjuhët respektive. KQZ, me synim efencën dhe efikasitetin e realizimit të projektit të informimit dhe edukimit zgjedhor të pakicave kombëtare, me qëllim sensibilizimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në votime, institucionalizoi bashkëpunimin me Komitetin Shtetëror të Pakicave Kombëtare përmes nënshkrimit të një Memorandumi Bashkëpunimi.

Të gjithë materialet informuese/edukuese/ndërgjegjësuese, që KQZ prodhoi për procesin zgjedhor të datës 30.06.2019, u prodhuan edhe në gjuhët e nëntë pakicave kombëtare. Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare realizoi përkthimin në gjuhët e pakicave kombëtare të materialeve informuese, edukuese dhe ndërgjegjësuese për zgjedhjet e datës 30.06.2019, si dhe u angazhua për shpërndarjen e tyre në njësitë e vetqeverisjes vendore me numrin më të madh të tyre. Në bashkëpunim me Policinë e Kufirit, fletëpalosje në gjuhë të pakicave kombëtare u shpërndanë në të gjithë pikat e kalimit kufitar, në numër më të madh në pikat kufitare me vendndodhje pranë territoreve të banuara nga pakicat kombëtare përkatëse. KZAZ-ve që ushtronin veprimtarinë në territore me vendbanim të pakicave kombëtare, i'u shpërndanë fletëpalosje edhe në gjuhë të pakicave kombëtare përkatëse.

Posterat dhe fletëpalosjet, në gjuhët të pakicave kombëtare, dhanë informacion të plotë për llojin dhe datën e zgjedhjeve, sistemin e zgjedhjeve vendore, oraret dhe procedurat e votimit,



dokumentet e identifikimit për votim, të drejtat dhe detyrat e zgjedhësve, veprat penale që çënojnë zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Fletëpalosjet në gjuhë të pakicave kombëtare u shpërndanë në njësitë e vetqeverisjes vendore ku personat që u përkasin pakicave kombëtare përbëjnë mbi 20 përqind të numrit të përgjithshëm të popullsisë, bazuar në informacionin e dërguar nga Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështjen e Vetëqeverisjes Vendore, e cila referonte të dhëna për popullsinë banuese dhe pakicat kombëtare përkatëse në nivel bashkie si dhe në nivel qarku.

Posterat informues dhe edukues në gjuhë të pakicave kombëtare (5 lloje), u dërguan në KZAZ-të përkatëse për t'u shpërndarë dhe afishuar në Qendrat e Votimit me vendodhje në njësitë e vetqeverisjes vendore me numrin më të madh të pakicave kombëtare (mbi 4.000 postera për t'u afishuar në rreth 1.000 QV).

Informacione për zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 30.06.2019, si dhe mesazhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votime u përcollën nga Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare, në kuadër të bashkëpunimit me KQZ, përmes hapësirës mediatike në gjuhë të secilës pakicë kombëtare që transmetohet në Radio Televizionin Shqiptar (lajmet ditore).

Për pakicat kombëtare romë dhe egjiptjane, edukimin zgjedhor të cilave KQZ e ka në fokus të punës në vijimësi, u realizua projekti i veçantë "Vota ime vlen", në bashkëpunimin me IRCA (Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri), mbështetur nga Instituti Demokratike Amerikan (NDI). Njëzet e pesë (25) studentë romë nga të 12 qarqet e vendit u trajnuan nga administrata e KQZ-së dhe u aftësuan për të zhvilluar sesione edukimi zgjedhor në komunitet. Të rinjtë e trajnuar, në bashkëpunim me administratën e KQZ-së realizuan mbi 26 sesione edukimi zgjedhor në vendqëndrimet e komunitetit rom në qarqet Gjirokastrë, Lezhë, Durrës, Delvinë, Berat, Fier, Korçë, Tiranë, Elbasan, Shkodër, Pogradec. Në këto sesione morën pjesë rreth 900 anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptjan nga të cilët 432 ishin femra, ndërsa 468 ishin meshkuj.

Studentët rom të angazhuar si trajnerë, ishin në ndihmë të komunitetit gjatë muajit qershor 2019 për të orientuar zgjedhësit për qendrat e votimit ku ishin të regjistruar, vendodhjen e tyre, si dhe për adresimin e problemeve të ndryshme të komunitetit në prag zgjedhjesh, përfshirë edhe tentativa për blerjen e votës. Në sesionet e edukimit numri i kontaktit të trajnerit i'u vendos në dispozicion pjesëmarrësve për të raportuar çdo situatë që mund të pengonte pjesëmarrjen e lirë në zgjedhje. Metodologjia dhe mjetet e përshatura, bënë që sesionet e edukimit zgjedhor të ndiqeshin me interes nga komunitetet romë dhe egjiptjane, duke i qartësuar procedurat e votimit dhe rritur besimin për të ushtruar të drejtën e votës në mënyrë të pandikuar.



Gjithashtu, KQZ në bashkëpunim me prezencën e OSCE, realizoi në vendqëndrimet e komuniteteve rome dhe egjiptjane projektin tjetër informues dhe ndërgjegjësues me fokus gratë dhe të rinjtë, për trajtimin e fenomenit negativ të shit-blerjes së votës, pasojat individuale dhe shoqërore në rast të tjetërsimit të vullnetit përkundrejt ofrimit/dhenies së të hollave apo të mirave materiale, si dhe të votimit familjar. Në sesionet që u realizuan në kuadër të këtij projekti morrën pjesë 356 anëtarë të komuniteteve rome dhe egjiptjane, (198 gra and 158 burra).

Të dy projektet, synuan lënien e një trashëgimie afatgjatë në komunitete, nëpërmjet trajnimit të temave me rëndësi themelore për demokracinë, ndërgjegjësimit të anëtarëve të komunitetit për të bërë zgjedhjen e tyre në mënyrë të pandikuar, dhe si të vlerësojnë mbajtjen e përgjegjësiive nga të zgjedhurit.

Faqja zyrtare e KQZ-së, shërbeu edhe për këto zgjedhje për komunikim me votuesit, kryesisht votuesit e rinj. Rubrika “Hapat që ndjek zgjedhësi gjatë ditës së votimit” një formë komunikimi interaktive bashkëkohore për zgjedhësit, publikimi i të gjithë materialeve të fushatës zgjedhore të KQZ-së, spote, postera, fletëpalosje, ishte një paketë e plotë informative. Informimi i shtetasve për mundësinë për të ndjekur ‘on line’ të gjitha mbledhjet e KQZ-së, krijoi mundësinë që çdo i interesuar të kuptojë përgjegjësitë ligjore të KQZ-së, si dhe të ndjekë hap pas hapi ecurinë e procesit zgjedhor, punën për organizimin dhe administrimin e tij, dhe të njihet me rezultate e votimit në kohë reale.

Realizimi i harmonizuar i programeve të ndryshme edukuese, informuese dhe sensibilizuese, drejtimit, format dhe mjetet eficientë të komunikimit, përmbushi objektivat strategjike të KQZ-së për fushatën për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019, si dhe për periudhën jozgjedhore, duke i shërbyer qasjes sa më pranë votuesit, me informacion dhe mesazhe që forcojnë kulturën zgjedhore.

I.9 REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

I.9.1 Regjistrimi i partive politike / kandidatëve.

Në mbështetje të nenit 64 Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacion, i cili vërteton regjistrimin si parti politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, emrin e partisë, shkronjat nistore të partisë, emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, financierit dhe të personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.



- **Regjistrimi i partive politike**

Pas daljes së Dekretit të Presidentit të Republikës, nr. 10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës 30 Qershor 2019, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, 36 parti politike e respektuan afatin dhe kriteret ligjore për t’u regjistruar si subjekte zgjedhore, në zgjedhjet e për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, si më poshtë:

- 1- Partia Socialiste e Shqipërisë;
- 2- Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;
- 3- Partia Demokracia Sociale;
- 4- Partia Aleanca Demokratike Shqiptare;
- 5- Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;
- 6- Partia Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane;
- 7- Partia G 99;
- 8- Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet;
- 9- Partia Ardhmëria Shqiptare;
- 10- Partia Demokrate për Integrim dhe Prosperitet;
- 11- Partia e Gjelbër;
- 12- Partia Pajtimit Kombëtar Shqiptar;
- 13- Partia Kristian Demokrate;
- 14- Partia Reformave Demokratike Shqiptare;
- 15- Partia e të Drejtave të Mohuara;
- 16- Partia Unitetit Kombëtar;
- 17- Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare;
- 18- Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve;
- 19- Partia Socialiste e Moderuar;
- 20- Partia Socialpunëtore Shqiptare;
- 21- Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë;
- 22- Partia Aleanca Kuq e Zi;
- 23- Partia Bashkimi Liberal Demokrat;
- 24- Partia Demokracia e Re Europiane;
- 25- Partia Balli Kombëtar;
- 26- Partia Emigracionit Shqiptar;
- 27- Partia Ora e Shqipërisë;
- 28- Fryma e Re Demokratike;
- 29- Partia Komunitse e Shqipërisë;
- 30- Partia Personat me Aftësi të Kufizuar;



- 31- Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian;
- 32- Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë;
- 33- Partia Kombëtare Konservatore Albania;
- 34- Partia për Liri Demokraci dhe Etikë;
- 35- Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen;
- 36- Partia Bindja Demokratike;

Në KQZ u regjistruan si subjekt zgjedhor 2 koalicione zgjedhore

- I. Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane me (21 Parti).
- II. Koalicioni Shpresa për Ndryshim me (6 Parti).
- III. Parti Politike që kandiduan më vete ishin (9 Parti).

Në datën 10.06.2019 Presidenti i Republikës nxori dekretin nr. 11199, “Për shfuqizimin e dekretit nr.10928, datë 05.11.2019 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019”, duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”.

Referuar dekretit të sipërpërmendur Partia Uniteti Kombëtar, në datën 13.06.2019, ka paraqitur në KQZ kërkesën për ç’regjistrimin e saj nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019. KQZ, me vendimin nr. 836, datë 13.06.2019 vendosi, rrëzimin e kërkesës së Partisë Uniteti Kombëtar për ç’regjistrim nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019 dhe heqjen emrit nga fletët e votimit, të Partisë Uniteti Kombëtar. Kundër vendimit të sipërcituar subjekti politik Partia Uniteti Kombëtar bëri ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Zgjedhor me vendimin nr.12, datë 24.06.2019 vendosi rrëzimin e kërkesë padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të KQZ-së.

Në datën 27.06.2019 Presidenti i Republikës nxorri dekretin nr. 11211, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore për t’u zhvilluar në datën 13 tetor 2019”.

Në datën 05.08.2019 u depozituan 3 kërkesa për regjistrimin e partive politike për të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 13 tetor 2019, si më poshtë:

- 1- Lëvizja Socialiste për Integrim;
- 2- Partia Republikane e Shqipërisë;
- 3- Partia Agrare Ambientaliste

Referuar nenit 24, pika 5 e Kodit Zgjedhor, mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë të saj. Në datën 07.08.2019, do të shyrtoheshin kërkesat për regjistrimin e partive politike të sipërpërmendura, por mbledhja e KQZ-së nuk u zhvillua për



mungesë kuorumi.

Referuar nenit 145 pika 2, e Kodit Zgjedhor, asnjë nga subjektet e sipërpërmendura nuk depozitoi ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

- **Regjistrimi i kandidatëve**

Në bazë të nenit 70, të Kodit Zgjedhor, 16 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit u regjistruan si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019, si më poshtë:

- 1- Majlinda Adem Ndrecaj
- 2- Fran Ndue Jushi;
- 3- Areti Aristidh Nasho;
- 4- Plarent Xhorxhi Aleksi;
- 5- Mond Lifter Loli;
- 6- Vasillaq Harilla Bollano;
- 7- Petro Zizo Bozhori;
- 8- Bedri Selman Hoxha;
- 9- Fezi Xheladin Shaholli;
- 10- Mehmet Sheref Nelaj;
- 11- Albert Rapush Shopi;
- 12- Gjon Gjete Ndoj;
- 13- Ilir Hasan Nikolla;
- 14- Bali Avni Jazaj;
- 15- Leonidha Vasil Histro;
- 16- Silva Jorgji Burbo;

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u regjistruan 97 kandidatë për kryetar bashkie të propozuar nga koalicionet dhe partitë politike që kandiduan më vete. Për 10 bashkitë që mbulohen nga më shumë se një KZAZ, e që procesi i regjistrimit të kandidatëve verifikohet e miratohet nga KQZ, u administruan e kontrolluan 123 lista shumemërore për kandidatë për anëtar të këshillit bashkiak.

Pas verifikimit u miratuan 108 lista shumemërore me rreth 3.442 kandidat. Mangësitë që u gjetën në këto kandidime (probleme gjinore, banimi, mangësi dokumentacioni, dublime) i'u kthyen propozuesve për plotësim. Pasi u korrigjuan dhe u plotësuan mangësitë, u miratuan nga KQZ. Pjesa tjetër e kandidimeve që erdhi në KQZ pas miratimit nga KZAZ-të përkatëse, u administrua nga administrata e KQZ-së.



Të dhëna të përmbledhura për kandidatimet jepen në tabelën më poshtë:

| | Kandidatë | Subjekte | | Të pavarur | |
|---|-----------|----------|-------|------------|-------|
| | | Meshkuj | Femra | Meshkuj | Femra |
| Kandidatë për kryetar | 97 | 80 | 11 | 6 | 0 |
| Fituese kryetar | 61 | 53 | 8 | 0 | 0 |
| Kandidatë në listat shumemërore për këshilltarë | 9872 | 5033 | 4839 | 7 | 3 |
| Kandidatë fitues për këshilltarë | 1.619 | 913 | 706 | 1 | 1 |

II. PJESA E DYTË – PERIUDHA ZGJEDHORE

II.1 AKREDITIMI I VËZHguesVE

Shqipëria, si anëtare e OSBE-së por dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, ka përmbushur në një masë të vlerësueshme detyrimin për të garantuar vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues ndërkombëtar dhe vendas (bazuar edhe në artikullin 7 të dokumentit të Kopenhagut të 1990).

Akreditimi i vëzhguesve vendas dhe të huaja u bazua në Udhëzimin e KQZ Nr. 13, datë 22.04.2009 “Mbi përcaktimin e rregullave të vëzhgimit të procesit zgjedhor, akreditimit, të drejtat dhe detyrat, kriteret dhe standardet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat jofitimprurëse shqiptare, organizmat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”.

Subjekteve të akredituara (vendase dhe të huaja) i’u vunë në dispozicion një set i plotë dokumentacioni në funksion të realizimit dhe lehtësimit të misionit të tyre, siç janë:

- Vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së;
- Përmbajtjen e fletëve të votimit dhe tabelave të rezultateve;
- Të dhëna për KZAZ-të dhe VNV-të (përmbajtja dhe vendndodhja);
- Të dhëna për QV-të;

Përveç këtij dokumentacioni, KQZ përgatiti në gjuhën shqipe dhe angleze një Udhëzues praktik, të orientuar kryesisht për vëzhguesit e huaj. Udhëzuesi jepte njohuritë thelbësore për sistemin dhe procesin zgjedhor në Shqipëri, si dhe përmbledhte informacion të përgjithshëm për Shqipërinë. Kemi konstatuar me kënaqësi, se kjo paketë informuese ka ndihmuar në realizimin e misionit të vëzhgimit dhe në kuptimin më të drejtë të specifikave të procesit zgjedhor në Shqipëri.

Zgjedhjet e 30 qershorit 2019, krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, u vëzhguan nga një numër jo shumë i madh organizatash jo qeveritare, organizma ndërkombëtare, përfaqësi diplomatike në Shqipëri dhe Media. E pasqyruar në shifra, janë akredituar gjithsej **2,091** vëzhgues.

Vëzhgues vendas ishin **1,413**, nga të cilët 169 vëzhgues afatgjatë, 461 vëzhgues afatshkurtër dhe 783 përfaqësues të medias. Vëzhgues të huaj ishin 678, nga të cilët 273 vëzhgues afatgjatë, 221 vëzhgues afatshkurtër dhe 35 përfaqësues të medias dhe 149 përkthyes.

II. 2 Monitorimi i fushatës zgjedhore dhe vëzhgimi i procesit.

KQZ pas shqyrtimit të propozimeve të ardhura nga organizatat jo fitimprurëse, vendosi ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias. Gjatë zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, BMM-ja monitoroi 14 operatorë televizivë dhe paraqiti 24 raporte ditore pranë KQZ-së, ndërsa 4 raporte javore u shqyrtuan nga KQZ-ja në mbledhje të hapura.

BMM-ja konstatoi se operatorët televizivë të monitoruar nuk e kishin respektuar kohën e transmetimit të fushatës zgjedhore të partive politike për shkak të specifikave të fushatës zgjedhore të subjekteve të ndryshme. Gjithashtu, konstatoi se balancimi i kohës mes subjekteve garuese në zgjedhje bëhej me minutazhin e partive politike të partive të spektrit të djathtë të cilat nuk ishin garuese në zgjedhje.

Shqetësim për KQZ-në mbetet shtrirja e monitorimit mbi të gjithë operatorët audiovizivë, pasi në Shqipëri ekzistojnë 55 televizione lokale dhe kombëtare, 57 radio lokale dhe kombëtare, ndërkohë që Autoriteti i Medias Audiovizive ofron mundësinë për të monitoruar vetëm 14 operatorë audiovizivë.

Vitet e fundit në Shqipëri po aplikohen platformat televizive online (televizione vetëm në uebsite interneti), të cilat mbeten jashtë monitorimit të BMM-së, pasi Kodi Zgjedhor parashikon vetëm monitorimin e operatorëve audiovizivë, të cilët janë nën juridiksionin e Autoritetit të Medias Audiovizive.

Epoka e teknologjisë së informacionit ka ndikuar edhe në përzgjedhjen e formatit për të bërë fushatë elektorale nga ana e partive politike, duke e zhvendosur nga mediat tradicionale në



mediat sociale dhe ato online.

Pasqyrimi i fushatës elektorale në mediat sociale dhe ato online nuk monitorohet nga BMM-ja pasi mungon kuadri ligjor dhe kjo ka sjellë jo vetëm pabarazi të pasqyrimin të fushatës për partitë politike dhe kandidatët e pavarur, në aspektin e hapësirës mediatike që u jepet atyre, por dhe të kostove financiare që zbatohen në mënyrë preferenciale.

II.3 Aksesit i medias dhe publikut

Transparenca e veprimtarisë së KQZ-së, për vet misionin që ky institucion përmbush, është një nga garancitë për rritjen e besimit të publikut në procesin zgjedhor. Veçanërisht në një vit zgjedhor, interesimi i publikut dhe medias për aktivitetin e KQZ-së rritet ndjeshëm. Pasqyrimi i zgjedhjeve nga media është një faktor vendimtar në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike pasi qëllimi final i pasqyrimin në media i veprimtarisë së KQZ-së dhe fushatës zgjedhore, është informimi i drejtë i votuesve dhe transparenca për publikun.

Media pasqyron aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor, shpërndan informacion mbi vendimmarrjen e KQZ, platformat e partive politike apo kandidatëve të pavarur dhe informacion që edukon zgjedhësit shqiptar.

Seancat e mbledhjeve të KQZ janë përherë publike, kanë gjithmonë vëmendjen dhe praninë e medias dhe mund të ndiqen drejtpërsëdrejti nga faqja zyrtare e internetit të KQZ-së. Në kuadër të kësaj transparence, KQZ ka përdorur të gjitha mënyrat e komunikimit për njoftuar rregullisht dhe në kohë, jo vetëm subjektet zgjedhore, por edhe të gjitha mediat e shkruara dhe audiovizive.

Ashtu si në zgjedhjet pararendëse, një faktor i rëndësishëm në rritjen e transparencës së veprimtarisë së KQZ-së, ishte:

- Publikimi në faqen zyrtare të KQZ në internet, i formularëve të vetë deklarimit dhe jetëshkrimet (CV) e çdo kandidati për kryetar bashkie dhe për këshill bashkiak;
- Publikimi i rezultatit paraprak dhe atij përfundimtar. Të gjitha mediave, si dhe çdo qytetari të interesuar, i'u dha akses direkt në faqen zyrtare www.cec.org.al, por edhe në ekranet e KQZ-së, të vendosur brenda dhe jashtë ambienteve të saj.

Çdo informacion i cili përbën interes për publikun dhe median është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, duke i ofruar aksesin e nevojshëm të gjithë të interesuarve.

II.4 FLETA E VOTIMIT

KQZ duke vlerësuar integritetin e fletës së votimit, si një nga elementët që ndikon drejtpërsëdrejti në standardet e procesit zgjedhor, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor i kushtoi rëndësi të veçantë përcaktimit të specifikimeve të fletës së votimit, procesit të përgatitjes së fletëve të votimit, integritetit të prodhimit dhe më tej, shpërndarjes së tyre.

KQZ, në përmbushje të detyrave të veta, me vendimin nr. 11, datë 18.01.2019, miratoi modelin dhe specifikimet teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019. Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, në këto specifikime u përfshinë veç të tjerash dhe shënimi i numrit të qendrës së votimit e i Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës. Gjithashtu, fleta e votimit kishte elemente identifikuese të cilat nuk lexoheshin me sy të lirë në formën e barkodeve. Në përcaktimin e specifikimeve teknike, KQZ pati parasysh eksperiencat e zgjedhjeve të mëparshme për sa i përket numrit të subjekteve zgjedhore të regjistruara në fletën e votimit.

| | |
|---|------------------|
| Numri total i zgjedhësve ishte : | 3.536,016 |
| 2% i numrit të zgjedhësve: | 70,799 |
| Fletë votimi gjithsej: | 3,606,815 |

Pas administrimit të listave shumemërore për këshilltarë dhe kandidaturave për kryetar për të 61 bashkitë, KQZ miratoi përmbajtjen e fletës së votimit për çdo bashki.

II.5 PËRGATITJA E MATERIALEVE ZGJEDHORE (BMZ), TRANSPORTI DHE DORËZIMI

Logjistika Zgjedhore funksionon mbi bazën e një sistemi të centralizuar të organizimit, përgatitjes, transportit dhe mbledhjes së dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore. Si e tillë, ajo mund të mbështetet vetëm në burime dhe institucione që kanë mundësi të garantojnë një infrastrukturë të tillë, siç është Ministria e Mbrojtjes. Përgjithësisht, ky proces zgjedhor nuk ka patur problematikë të ngritur apo qoftë edhe të pretenduar për sa i përket materialeve zgjedhore. Materialet zgjedhore u siguruan dhe përgatitën brenda afateve ligjore që parashikon Kodi Zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të urdhërimeve dhe afateve kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, nëpërmjet gjithë Administratës realizoi me sukses shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe fletët e votimit në 90 Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Duhet theksuar se respektimi i këtij afati erdhi si rezultat i planifikimit në kohën e duhur të infrastrukturës së logjistikës zgjedhore dhe të bazuar në një sistem të organizuar dhe jo rastësor, duke garantuar një standart të përmirësuar të përgatitjes dhe administrimit të logjistikës



zgjedhore, si dhe dërgimi i saj në destinacionin e duhur (pranë çdo KZAZ), brenda afatit kohor të parashikuar në Kodin Zgjedhor.

Çdo Komision Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe Komision i Qendrës së Votimit (KQV) ka patur në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe materialet zgjedhore të domosdoshme për zbatimin e procedurave dhe përmbushjes së detyrave që Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, iu ngarkon këtyre komisioneve. Komisionet Zonale të administrimit Zgjedhor (KZAZ), Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) dhe Kryetarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, u pajisën me vulat sipas modeleve të miratuara nga KQZ dhe të prodhuara në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme. Vulat dhe materialet e tjera zgjedhore u dorëzuan me procesverbalet respektive, sipas modeleve të miratuara nga KQZ.

Element që duhet vënë në zbatim mbetet “Paketa ” e programit për logjistikën, i cili parashikon identifikimin me anë të *bar-code* të paketës së materialeve zgjedhore nga KQZ-KZAZ-KQV dhe anasjelltas. Kjo paketë nuk u aplikua dhe lëvizja e materialeve zgjedhore u bazua thjesht në sistemin e vërtetimit me anë të procesverbaleve të miratuara nga KQZ.

Problematika dhe risqe të menaxhuara

Vetëm dy ditë para zhvillimit të zgjedhjeve, disa KZAZ pësuan dëme të bazës materiale zgjedhore si kuti votimi, fletë votimi, dhoma të fshehta etj, për shkak të goditjeve nga faktorë të jashtëm. Më rëndë u dëmtuan materialet e KZAZ-së nr.06, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër dhe KZAZ-së nr. 17, Bashkia Klos, Qarku Dibër. Në këto rrethana, KQZ vendosi marrjen e masave emergjente për zëvendësimin e bazës materiale zgjedhore në këto KZAZ, që solli rritje të kostos dhe vështirësi të shtuar në shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore nga KZAZ në KQV. Koordinimi i këtyre aktiviteteve të emergjencës, angazhimi i Anëtarëve dhe Administratës së KQZ, anëtarëve të KZAZ-ve si dhe strukturave të tjera shtetërore, solli realizimin e objektivave në kohë.

II.6 Dita e Zgjedhjeve

Ditën e zgjedhjeve anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, u paraqiten në qendrën e votimit në ora 6:00, një orë para hapjes së votimit, duke përmbushur detyrat dhe procedurat paraprake për organizimin e qendrës së votimit.

Procesi i votimit nuk u zhvillua në 9 Qendra Votimi në Bashkinë Shkodër, 7 prej të cilave me vendodhje në njësinë administrative Bërdicë, një me vendndodhje në njësinë administrative Dajç dhe një me vendndodhje në njësinë administrative Gur i Zi, për shkak të bllokimit të ambienteve dhe situatës së tensionuar përreth tyre.



Në disa qendra votimi të Bashkisë Shkodër, për shkak të bllokimit të ambienteve në pronësi apo përgjegjësi administrimi të Bashkisë, pati problematika të cilat bënë që hapja e votimit të fillonte më vonë se ora 7:00.

Nuk pati asnjë rast të braktisjes së detyrës nga komisionerët e qendrave të votimit apo pezullim të votimit për më shumë se 6 orë, i cili do të çonte në pavlefshmëri të zgjedhjeve.

Raste të ndërprerjes së procesit të votimit ishin të pakta dhe në kohë të shkurtër, pasi rendi dhe qetësia u rivendos shpejt duke respektuar procedurat ligjore.

KQZ gjatë ditës së zgjedhjeve, publikoi informacion për pjesëmarrje në votime, sikundër edhe në proceset zgjedhore të mëparshme. Kodi Zgjedhor në asnjë dispozitë të tij nuk përcakton detyrimin që KQZ të publikojë informacion për pjesëmarrje në zgjedhje gjatë ditës së votimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pavarësisht se pa detyrim të shprehur në Kodin Zgjedhor, në respekt të opinionit dhe interesit publik, si dhe rritjes së transparencës për procesin zgjedhor, realizon dhënien e informacionit për pjesëmarrje në votim gjatë ditës së zgjedhjeve, mbi bazën e shifrave të dhëna nga KZAZ-të përmes e-mail apo telefonit celular. KZAZ-të marrin të dhënat nga Sekretarët e KQV-vë në oraret e përcaktuara, përmes telefonit celular, dhe mbi bazën e tyre informojnë KQZ-në për shifrën e pjesëmarrjes në votime.

Bazuar në nenin 12, të Udhëzimit të KQZ-së nr. 2/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Qendrës së Votimit”, Sekretari i KQV ka detyrë të njoftojë KZAZ-në çdo tre orë pas orës së hapjes së votimit, për numrin e zgjedhësve që kanë votuar deri në atë moment, dhe pas mbylljes së votimit për numrin e zgjedhësve që kanë votuar dhe përkatësinë gjinore të tyre. Transmetimi i të dhënave nga Sekretari i KQV bëhet përmes telefonit celular. Për shkaqe objektive si mos mbulimi i zonave të caktuara gjeografike me sinjal telefonik, apo mos përgjegjshmërisë të sekretarëve të QV-ve përsa i përket dërgimit të të dhënave në orar, informacioni i KQZ për pjesëmarrje në votime, sikundër edhe në procese të tjera zgjedhore, nuk përfshiu të gjithë QV në rang vendi.

Gjithashtu, duhet marrë në konsideratë fakti që shifra e transmetuar nga Sekretari i KQV-së, jo gjithmonë ka saktësi maksimale pasi lista e zgjedhësve ku mund të verifikohet numri i votuesve përmes nënshkrimeve administrohet nga Kryetari i KQV-së. Komisioni i Qendrës së Votimit, pas mbylljes së votimit, pra pas orës 19:00, kryen procedurat dhe nxjerr të dhëna të sakta, përfshirë edhe numrin e zgjedhësve që kanë votuar, dhe i dokumenton ato në procesverbalin që plotëson duke respektuar procedurat e nenit 113 të Kodit Zgjedhor.

Në orën 19:00, kur Sekretari i KQV kryen raportimin e fundit përmes telefonit celular, ai nuk disponon të dhënën e saktë për numrin e zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime, pasi Kryetari i KQV, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV dhe të vëzhguesve, nuk ka kryer



ende veprimet për përcaktimin e numrit të zgjedhësve që kanë votuar mbi bazën e nënshkrimeve të tyre në listën e zgjedhësve dhe në Rregjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve.

Në faqen zyrtare të KQZ, verifikohet lehtësisht se informacioni i publikuar nga KQZ për pjesëmarrje në votime edhe në zgjedhjet e mëparshme është cilësuar “pjesëmarrja e votuesve nga qendrat e votimit që kanë dërguar të dhëna”, fakt i cili dëshmon se informacioni që dha KQZ-së për pjesëmarrje në votime më datë 30 qershor referoi të njëjtën metodologji, pavarësisht aludimeve apo pretendimeve të shprehura. Për ilustrim, në zgjedhjet 2017, të dhënat e publikuara nga KQZ për pjesëmarrjen në zgjedhje në orën 10:00 referonin raportimet e bëra nga 25% e QV; në orën 13:00 referonin raportimet e bëra nga 26,37% e QV, në orën 16:00 referonin raportimet e bëra nga 11,30% e QV, dhe në orën 19:00 referonin raportimet e bëra nga 19% e QV.

KQZ nuk disponon një modul për të realizuar transmetimin e informacionit për pjesëmarrje në votime ditën e zgjedhjeve. Përmes Sistemit të Integruar të Manaxhimit Elektronik të Informacionit Zgjedhor (IEMIS), që ka filluar të ndërtohet prej vitit 2013 me ndihmën e donatorëve, kryesisht USAID, KQZ administron një volum të madh informacioni. Ky sistem ka të zhvilluar dhe të vënë në përdorim modulet kryesore që kanë të bëjnë me publikimin e rezultateve zyrtare të çdo qendre votimi gjatë procesit të numërimit.

KQZ sqaroi se në zgjedhjet e datës 30 qershor, sikundër edhe në proceset zgjedhore të mëparshme, shifrat zyrtare për pjesëmarrje në votim disponohen vetëm nga dokumentacioni zyrtar zgjedhor: procesverbalet e plotësuar nga KQV pas mbylljes së votimit, po ashtu edhe tabelat e rezultatit të votimit të plotësuar nga Grupi i Numërimit të Votave.

Vëmendja dhe interpretimi që ju dha informacionit të KQZ-së për shifrat e pjesëmarrjes në votime në datë 30 qershor 2019, erdhi për shkaqe që janë përtej natyrës, misionit dhe punës së KQZ.

Të gjitha Qendrat e Votimit u mbyllën në orën 19:00. KQV, në prani të vëzhguesve kryen me korrektësi procedurat për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve të votimit.

II.7 Dorëzimi i materialit zgjedhor në KZAZ-të pas mbylljes së QV-së

Në orën 24:00, të datës 30 qershor 2019, në të gjitha Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor kishte përfunduar dorëzimi i kutive të votimit dhe kutive të materiale zgjedhore në respektim të procedurave dhe afatit ligjor. Kriteri i barazlargësisë së VNV nga qendrat e votimit, kushtet infrastrukturore të VNV-ve, njohja e mira e procedurave nga ana e komisionerëve, ishin faktorë që ndihmuan këtë proces.


II.8 Procesi i numërimit në VNV, tabulimi dhe nxjerrja e rezultatit nga KZAZ



Përgjithësisht, numërimi filloi në të gjitha KZAZ-të menjëherë pas përfundimit të procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore. Shkak për disa vonesa ishte lodhja e anëtarëve të grupeve të numërimit, të cilët kishin qenë dhe anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit.

Procesi i numërimit të votave përgjithësisht shkoi shumë mirë. Siguria në vendet e numërimit të votave ka qenë në të gjitha rastet në lartësinë e kërkuar, edhe në sajë të punës së Policisë së Shtetit. Nuk pati raste të prishjes së rregullit në VNV, për të cilat KZAZ-të të kërkonin ndihmën e punonjësit të Policisë së Shtetit për rivendosjen e tij. Transparenca përgjatë procesit të numërimit të votave dhe tabulimit të rezultatit nga GNV/KZAZ ishte e plotë.

Sistemi i kamerave dhe monitorëve të instaluar nga KQZ në çdo tavolinë të numërimit të votive, funksionoi në mënyrë efikase. Transmetimi në serverat e KQZ-së të tabelës së rezultateve të çdo qendre votimi, u krye në respekt të procedurës së miratuar nga KQZ-ja.



Procesi i numërimit përfundoi në datë 2 korrik 2019.

II.9 Publikimi i rezultatit paraprak, nxjerrja e rezultatit nga KQZ, rezultati përfundimtar.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave dhe plotësimit të tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi nga grupet e numërimit të votave për çdo zonë zgjedhore, KQZ-ja verifikoi tabelat e rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ për çdo zonë zgjedhore përkatëse dhe miratoi me vendim Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit për çdo zonë zgjedhore, mbështetur në origjinalet e tabelave të çdo qendre votimi sipas zonave zgjedhore, të plotësuara nga grupet e numërimit të votave.

Në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi bazën e rezultatit të votimit për çdo zonë zgjedhore, përlloragiti shpërndarjen e mandateve për çdo këshill bashkie si dhe kandidatët fitues për çdo parti politike.

Në rastin e përlllogaritjes dhe shpërndarjes së mandateve për çdo subjekt zgjedhor për 61 Bashki, referuar nenit 24 pika 1, germa “a” e Kodit Zgjedhor, konsiderohen të miratuara kur votojnë pro 5 anëtar të KQZ-së. Në këtë rast nuk u arrit votimi 5 pro për të shpërndarë mandatet për çdo subjekt zgjedhor për 61 Bashkitë. Shpërndarjen e mandateve për 61 Bashkitë e bëri Kolegji Zgjedhor.

Pas shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore si dhe në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në Kolegjin Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve me vendimin nr.1097, date 27.07.2019.

II.10 ANKIMET DHE STATUSI I TYRE

Ankimet në KQZ

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, përpara datës së zgjedhjeve janë depozituar në KQZ 14 kërkesa ankimore. Pas datës së zgjedhjeve në KQZ u depozituan gjithsej 47 kërkesa ankimore kundër vendimeve të KQZ.

Në çdo rast, kur kërkesa ankimore kishte indicie të mjaftueshme nga provat e paraqitura, fakte dhe argumente bindëse, KQZ-ja ka thelluar hetimin administrativ, duke këqyrur të gjithë dokumentacionin zgjedhor apo dhe materialin zgjedhor të ndodhur në rutinë e materialeve zgjedhore.

➤ Para Ditës së Zgjedhjeve

Në KQZ, para datës së zgjedhjeve u depozituan gjithsej 14 kërkesa ankimore me objekt: “Kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së, për mosregjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkie” dhe Kundërshtimin ndaj vendimit të KZAZ-së, për mosregjistrimin e listave shumëmeorore për Këshillin e Bashkisë”, nga subjektet zgjedhore si më poshtë.

- Partia Bindja Demokratike;
- Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;
- Partia Komuniste e Shqipërisë;
- Partia Aleanca Demokratike;
- Partia Ora e Shqipërisë;
- Partia Demokracia e Re Europiane;
- Partia Emigracioni Shqiptar;
- Partia Bashkimi Liberal Demokrat;
- Partia Uniteti Kombëtar.

Për 7 kërkesa është vendosur mos pranimin e kërkesës për Shqyrtim;

Për 5 kërkesa është vendosur ndryshimi i vendimit të KZAZ-së;

Për 2 kërkesa është vendosur lënia në fuqi e vendimit të KZAZ-së.



➤ **Pas Ditës së Zgjedhjeve**

Në KQZ, pas datës së zgjedhjeve u depozituan gjithsej 47 kërkesa ankimore me objekt: “Shpalljen e Pavlefshmërisë së zgjedhjeve në Bashkitë përkatëse”, nga subjektet zgjedhore si më poshtë:

- Partia Bindja Demokratike;
- Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë;
- Partia Emigracioni Shqiptar;
- Partia Kombëtare Konservatore Albania;
- Leonidha Hristo Kandidat i propozuar nga zgjedhësit;
- Ylber Gjeta (kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike);
- Edmond Piroli (kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike)

Për 42 kërkesa është vendosur lënia në fuqi e vendimit të KZAZ-së dhe Rrëzimi i kërkesës ankimore;

Për 4 kërkesa është vendosur mos pranimi i kërkesës për shqyrtim;

Për 1 kërkesë është vendosur pushimi i kërkesës ankimore;

Ankimet në Kolegjin Zgjedhor

➤ **Para Ditës së Zgjedhjeve**

Në periudhën para datës së zgjedhjeve u paraqitën në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, gjithsej 13 kërkesa ankimore.

Në Kolegjin Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, para datës së zgjedhjeve u depozituan gjithsej 13 kërkesa ankimore kundër vendimit të KQZ-së, nga partitë politike si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si më poshtë:

- Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar;
- Partia Lista e Barabartë (Gjergji Prifti)



- Dhionisios Alfred Beleri (kandidat i propozuar nga zgjedhësit)
- Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar;
- Partia Bindja Demokratike;
- Partia Kombëtare Konservatore Albania;
- Salvador Kaçaj (kandidat i propozuar nga Partia Bindja Demokratike)
- Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;
- Partia Demokratike e Shqipërisë;
- Bashkia Kamëz;
- Partia Uniteti Kombëtar

KËRKESAT ANKIMORE SIPAS OBJEKTIT:

- Partia Bindja Demokratike ka paraqitur 3 ankime në Kolegjin Zgjedhor me objekt:
 - 1- Kundërshtimi i vendimit të KQZ nr.230 datë 27.04.2019 "Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, Partia Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019"; Gjykimi e çështjes në themel dhe pranimin e plotë të ankimit dhe shfuqizimin e vendimit të KQZ-së objekt ankimi".
 - 2- Kundërshtimi i vendimit të KQZ-së nr.646, datë 23.05.2019, "Për lënien në fuqi të vendimit nr.4 datë 18.05.2019 të KZAZ-se nr.64 "Për mos regjistrimin e Kandidatit për Kryetar Bashkie Berat, z. Pavllo Shkarpa propozuar nga Bindja Demokratike dhe regjistrimin e zotit Pavllo Shkarpa si kandidat për kryetar bashkie për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019".
 - 3- Kundërshtimi i vendimit të KQZ nr.653, datë 26.05.2019 "Për lënien në fuqi të vendimit nr.06 date 18.05.2019 të KZAZ-se nr.46 'Për mos regjistrimin e Kandidatit për Kryetar Bashkie Cërrik znj. Merita Xhika propozuar nga Bindja Demokratike dhe regjistrimin e zonjës Merita Xhika si kandidate për kryetare bashkie Cërrik për zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019".

- Z. Gjergji Prifti, kryetar i Partisë Lista e Barabartë ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: "Kundërshtimi i vendimit të KQZ-së nr.463, datë 17.05.2019 "Për Shqyrtimin e kërkesës së Partisë Lista e barabartë për regjistrimin e listës shumemeroje të kandidateve për anëtar në këshillin e Bashkisë Durrës, Tiranë, Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor".

- Z. Dhionisios Alfred Beleri, si kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Himarë, ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: "Pavlefshmërinë absolute të vendimit të



KQZ-së nr.516 datë 17.05.2019, si dhe detyrimin e KQZ-së të regjistrojë si kandidat të pavarur të propozuar nga zgjedhësit”.

➤ Partia Aleanca Popullore ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtimi i vendimit të KQZ-së 599, datë 20.05.2019 "Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë Kamëz të propozuar nga Partia Bindja Demokratike z. Ylber Gjeta, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019”.

➤ Partia Aleanca Demokristiane ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtimi i vendimit nr.626, datë 22.05.2019 “Për pranimin e listave shumëme të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Durrës, Fier, Lezhë, Tiranë, Kamëz, Vlorë të paraqitura nga Partia Aleanca Demokristiane, pjesëtare e Koalicionit ”Aleanca Për Shqipërinë Europiane”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”.

➤ Partia Kombëtare Konservatore Albania ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtimi i vendimeve të KQZ nr. 592, nr. 535, nr. 536, nr. 537, ‘Mos pranimin e kërkesës së Partisë Kombëtare Konservatore Albania për dorëzimin e dokumenteve për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe listës shumëme të kandidateve për anëtar në këshillin e Bashkisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019”.

➤ Z. Salvador Kaçaj kandidat i propozuar nga subjekti Bindja Demokratike ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr.695 datë 28.05.2019, “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019; Gjykimi i çështjes në themel duke vendosur ç’regjistrimin nga fleta e votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të kandidatit për kryetar Bashkie të z. Salvador Kaçaj”.

➤ Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtimi i vendimit të KQZ-së nr.657, datë 23.05.2019; Gjykimin e Çështjes në themel duke vendosur pranimin e kërkesës për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve të propozuar nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim”.

➤ Bashkia Kamëz ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtimi i Vendimit nr.651, datë 26.05.2019 dhe vendimit nr.796 datë 03.06.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.



➤ Partia Uniteti Kombëtar ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtimi i vendimit të KQZ-së nr.836, datë 13.06.2019, me anën e të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Partisë së Unitetit Kombëtar (PUK) për t’u ç’regjistruar nga zgjedhjet për pushtetin vendor të 30 qershorit 2019”.

Për 11 ankime vendosi rrëzimin e kërkesë padisë;

Për 2 ankime vendosi pranimin e padisë;

➤ **Pas Ditës së Zgjedhjeve**

Në Kolegjin Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, pas datës së zgjedhjeve u depozituan në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, 71 kërkesa ankimore kundër vendimeve të KQZ-së, nga partitë politike si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si më poshtë:

- Partia Socialiste e Shqipërisë;
- Partia Bindja Demokratike;
- Leonidha Hristo (Kandiat i propozuar nga zgjedhësit)
- Hariz Mema (Kryetar i Partisë Demokratike, dega Sarandë)
- Aleksandër Mani (Kryetar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, dega Delvinë)

KËRKESAT ANKIMORE SIPAS OBJEKTIT:

- Partia Socialiste e Shqipërisë ka paraqitur 61 kërkesa ankimore në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtim ndaj mos marrjes vendim brenda afatit ligjor nga KQZ, Për shpërndarjen e mandateve për 61 Këshilliat e Bashkive, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore te datës 30 Qershor 2019”; Gjykimin e çështjes në themel dhe shpërndarjen e mandateve për Këshilliat e Bashkive, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore, sipas vendimeve të KZAZ-ve”.
- Partia Bindja Demokratike ka paraqitur 5 kërkesa ankimore në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtimi i Vendimeve të KQZ-së, ‘Për lënien në fuqi të vendimeve të KZAZ, Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve të 30 qershorit në Bashkinë Selenicë, Shijak, Kurbin, Berat, Tiranë”.
- Z. Leonidha Hristo kandidat i propozuar nga zgjedhësit ka paraqitur 1 kërkesë ankimore në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Kundërshtimi i Vendimit nr.1082, datë 11.07.2019 i



Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Tiranë; Detyrimin e të paditurit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Tiranë, të marrë në shqyrtim kërkesën ankimore datë 02.07.2019 dhe datë 10.07.2019, të paditësit Leonidha Hristo, me objekt: Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Finiq, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019”.

- Z. Hariz Mema, Kryetar i Partisë Demokratike Dega Sarandë, z. Aleksandër Mani, Kryetar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim Dega Delvinë dhe Kryetari i Bashkisë z. Rigels Balili kanë paraqitur 4 kërkesë ankimore në Kolegjin Zgjedhor me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjedhjeve të qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, të mbajtura në Republikën e Shqipërisë për Kryetarin e Bashkisë dhe për zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, për Bashkitë, Sarandë, Finiq, Konispol, Delvinë”.

Për 61 kërkesa është vendosur Pranimi i Kërkesës Ankimore;

Për 10 kërkesa është vendosur Rrëzimi i Kërkesës Ankimore;

III. PJESA E TRETË - PERIUDHA PASZGJEDHORE

III.1 FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE

III.1.1 Auditimi i partive politike për vitin 2018

Në zbatim të Ligjit nr.10374, datë 10.02.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, partitë politike dorëzojnë në KQZ raportet financiare, sipas modelit të raportit financiar miratuar me vendim nga KQZ.

Data 31 mars e vitit pasardhës, është afati i dorëzimit të raportit financiar, përcaktuar nga KQZ me vendimin nr. 14, datë 23.11.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.3, datë 18.01.2012 “Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar të ekspertëve kontabël”.

Për vitin kalendarik 2018, nga 128 parti politike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë dorëzuar raportet financiare vjetore në KQZ, vetëm 45 parti politike.

Raportet e auditimit të fondeve të partive politike për vitin kalendarik 2018 janë të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së në internet, në link-un: <http://cec.org.al/raportet-e-auditimit-per-fondet-vjetore-te-partive-politike/>

KQZ me vendimin Nr. 112, datë 27.03.2019 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e



ekspertëve kontabël të licencuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për vitin kalendarik 2018”, përzgjedhi me short dhe emëroi 23 ekspertë kontabël për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 113 parti politike gjatë vitit 2018. Pesëmbëdhjetë (15) parti politike të regjistruara në gjykatë nuk u përfshinë në shortin për përzgjedhjen e ekspertëve, pasi nuk kishin adresë dhe kryetar partie të deklaruar në regjistrin e partive politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi raportet e auditimit të ekspertëve kontabël, dhe përgatiti materialin mbi bazën e opinionit të shprehur prej tyre. Në përfundim të procesit të verifikimit të raporteve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2018, rezultoi se nga 113 parti politike të cilat duhet të auditoheshin:

- Për 56 parti politike, nuk u arritën të kontaktoheshin nga ekspertët kontabël për shkak të pasaktësisë së adresave të deklaruar nga këto parti politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për shkak të mosarritjes së kontaktimit me përfaqesues të partisë.
- Për 30 parti politike, ka deklaratë të kryetarit të partisë ose të autorizuarit të tij se partia nuk ka përfituar dhe shpenzuar fonde për vitin 2018.
- Për 22 parti politike, ekspertët kontabël kanë paraqitur një raport të rregullt auditimi. Për të gjitha këto parti politike, eksperti nuk ka vërejtje për mënyrën e përgatitjes së pasqyrave financiare.
- Për 2 parti nuk është arritur kryhet auditimi pasi nuk ka patur bashkëpunim nga ana e partisë.
- Për 3 parti nuk është dorëzuar raport auditimi nga ekspertët kontabël.

III.1.2 Financimi i partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019.

Reforma zgjedhore nuk arriti të bënte ndryshimet në ligjin “Për Partitë Politike” dhe Kodin Zgjedhor, në lidhje me transparencën financiare të partive politike. Megjithatë, KQZ-ja i adresoi rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, dhe rezolutës së Kuvendit brenda hapësirave dhe kompetencave që i njeh ligji.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi 3 akte të rëndësishme nënligjore:

- “Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore”;



- “Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore;
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.1, datë 31.05.2017 “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Të tre aktet i shërbejnë objektivit për rritjen dhe transparencën financiare të fushatave. Nga zbatimi i këtyre tre akteve, partitë politike dhe kandidatët për kryetar bashkie, si edhe kandidatët e mbështetur nga zgjedhësit, treguan më shumë vetëdije, ligjëshmëri dhe përgjegjshmëri në veprimtarinë e tyre të raportimit financiar, qasje të standardizuar nga KQZ në mbikëqyrje, eficiencë në kontroll dhe monitorim, si dhe angazhim pro aktiv të shoqërisë në monitorimin e ligjzbatimit.

Në zgjedhjet për qeverisjen vendore 2019, nuk raportuan vetëm partitë politike për financat e fushatës, por edhe kandidatët për kryetarë bashkie. Kjo do të thotë më shumë trasparencë, më pak informalitet, më shumë barazi dhe më shumë ndershmëri në konkurrim.

Aktet nënligjore të KQZ-së, rregulluan të drejtën e individëve të cilët kanë interesa të ligjshëm t’i drejtohen KQZ-së me kërkesa/ankesa/denoncime në lidhje me financimin e fushatave zgjedhore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori një ankesë në datën 04.02.2019, që pretendonte përdorimin e paautorizuar të burimeve shtetërore në funksion të fushatës elektorale. Në veçanti, ankesa pohonte se disa institucione shtetërore kanë vendosur në faqet e tyre të internetit imazhe dhe slogane të përdorura në fushatë nga parti politike. KQZ-ja shqyrtoi pretendimin e ngritur në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit “Për Partitë Politike” të ndryshuar. Neni 88 i Kodit Zgjedhor në mënyrë eksplicite ndalon përdorimin e burimeve të organeve publike në nivel qendror apo lokal në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve zgjedhore.

Në përgjigje të kësaj ankese, KQZ ju drejtua me shkresë zyrtare të gjitha institucioneve për t’iu kujtuar atyre ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në nivel qendror dhe lokal në funksion të fushatës zgjedhore. Institucionet reagueshin pjesërisht duke hequr imazhet të tilla nga faqet e tyre të internetit.

Për zgjedhjet e vitit 2019 u regjistruan si subjekte zgjedhor gjithësej 36 parti politike. KQZ emëroi 34 auditues ligjorë, të cilët kryen monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e organeve vendore 2019 (vendimi i KQZ-së nr.740, datë 31.05.2019). Tridhjetë e katër (34) audiuesit ligjorë, lidhën kontratën e shërbimit me KQZ-në.

Gjatë muajit të fushatës zgjedhore janë depozituar 4 raporte monitorimi të ndërmjetëm, të cilat



janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në internet, link-u; <http://cec.org.al/raporte-te-monitorimit-te-fushates-zgjedhore/>.

Afati i fundit i dorëzimit të raporteve financiare për fushatën zgjedhore 2019 ishte data 26.09.2019 (jo më vonë se 60 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve). Njëzet e dy (22) parti politike nga tridhjetë e gjashtë (36) parti të regjistruara si subjektet zgjedhor, kanë dorëzuar raport financiar për fushatën zgjedhore. KQZ ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet financiare të fushatës zgjedhore në link-un; <http://cec.org.al/raportet-financiare-fushaten-zgjedhore-2019/>

Tridhjetë e katër (34) ekspertët e emëruar (vendimi nr.740 datë 31.05.2019), monitoruan dhe audituan për fondet dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore 36 parti politike dhe 16 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit.

Afati i fundit i dorëzimit të raporteve të monitorimit përfundimtar nga ekspertët financiarë ishte data 26.11.2019 (jo më vonë se 4 muaj nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve). Ekspertët financiar kanë depozituar në KQZ 35 raporte të monitorimit përfundimtar të fushatës zgjedhore.

Raportet financiare të fushatës zgjedhore janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në internet në link-un; <http://cec.org.al/raportet-e-monitorimit-perfundimtar-te-fushates-zgjedhore-2019/>

Afati i fundit i dorëzimit të raporteve të auditimit të fushatës zgjedhore ishte data 16.12.2019 (jo më vonë se 20 ditë nga dorëzimi i raportit të monitorimit përfundimtar). Audituesit kanë depozituar në KQZ 35 raporte auditimi. Audituesit kanë certifikuar financimin e fushatës zgjedhore për 35 parti politike.

Raportet auditimit të fushatës zgjedhore janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në internet në link-un; <http://cec.org.al/raportet-e-auditimit-te-partive-politike/>

Aktualisht, KQZ është në procesin e verifikimit dhe kontrollit, për respektimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore për financimin e fushatës zgjedhore, në lidhje me fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partia politike gjatë fushatës zgjedhore.

Verifikimi po bëhet duke:

- Krahasuar të dhënat me gjetjet dhe konkluzionet e Raportit të Auditimit të Fushatës Zgjedhore dhe Raportit të Monitorimit të Fushatës Zgjedhore;
- Kontrolluar procedurën e dokumentimit të dhurimeve (nëse dhuruesi ka nënshkruar deklaratën e kërkuar nga neni 90, pika 1 e Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, limitin e vlerës



së dhurimit si dhe nëse dhurimi i fondeve jopublike është në llogarinë e posaçme të hapur për këtë qëllim);

- Kontrolluar nëse fondet e përfituara dhe shpenzuara nga kandidatët për fushatën zgjedhore janë deklaruar në raportin e dorëzuar nga partia politike;
- Rillogaritur totalin e shpenzimeve të deklaruar të fushatës zgjedhore dhe duke e krahasuar atë me limitin e lejuar për subjektin zgjedhor.

Në rast se KQZ, do të konstatojë shkelje të dispozitave ligjore dhe akteve normative të nxjerra nga KQZ, kur nuk përbën vepër penale, do të zbatojë sanksionet e parashikuara në nenin 172, nenin 173 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar dhe nenit 24/2, pika 7 të nenit 23/4 të ligjit nr. 8580/2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

KQZ, në vendosjen e sanksioneve bazohet në parimin e proporcionalitetit.

IV. PJESA E KATËRT – VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-së

IV.1 Marrëdhëniet me institucionet e tjera

Bashkëpunimi dhe ndërveprimi i KQZ me institucione të tjera, të ngarkuara ose jo me detyra nga Kodi Zgjedhor, edhe për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019 shënoi nivel të lartë, si praktikë tashmë e konsoliduar për çdo proces zgjedhor dhe shprehje vullneti për mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

KQZ shpreh falenderime për të gjithë institucionet shtetërore që me angazhimin dhe kontributin e tyre, ishin një vlerë e shtuar në përmbushjen me sukses dhe në kohë të detyrave, dhe në veçanti për:

- Policinë e Shtetit, për kryerjen me korrektësi të detyrave që Kodi Zgjedhor i ngarkon për garantimin e rregullit dhe të qetësisë në çdo ambient zgjedhor, veçanërisht në Qendrat e Votimit gjatë ditës së votimit, në Vendet e Numërimit të Votave, shkëmbimin korrekt dhe në kohë reale të informacionit për çdo rast të evidentimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin. Në zbatim të përcaktimeve të kuadrit ligjor, KQZ dhe Policia e Shtetit shkëmbyen informacione me të dhëna të plota për objektet zgjedhore dhe adresat e vendndodhjeve të tyre, si dhe të dhëna të plota për punonjësit e Policisë së Shtetit që do të angazhoheshin, sipas detyrës dhe objektit zgjedhor ku ishin caktuar.



- Ministrinë e Arsimit, për vënien në dispozicion të ambienteve të shkollave për: krijimin e selive të KZAZ-ve, qendrave të votimit, vendeve të numërimit të votave, për realizimin e trajnimeve për komisionerët zgjedhorë, si dhe veçanërisht për vënien në dispozicion të kompjuterave PC për KZAZ selitë e të cilave ishin në shkolla.
- Ministrinë e Mbrojtjes, për angazhimin në realizimin e transportin e bazës materiale zgjedhore, nga KQZ-ja në KZAZ-të, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe anasjelltas.
- Institucionet e Prefektëve, për sigurimin e ambienteve të punës për Zyrat Rajonale Zgjedhore.
- OSHEE, për garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike të objekteve zgjedhore, përgjatë gjithë procesit zgjedhor, dhe veçanërisht të Qendrave të Votimit.
- Autoritetin e Mediave Audiovizive, për vënien në dispozicion të BMM të kapaciteteve teknike për nevoja të monitorimit të fushatës zgjedhore, në radion dhe televizionin publik dhe privat, për regjistrimin e programeve të operatorë televizivë në mënyrë dixhitale.
- Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, për zbatimin e ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Institutin e Ekspertëve Kontabël të Licensuar (IEKA) për vënien në dispozicion të ekspertizës dhe kapaciteteve njerëzore për realizimin e monitorimit të financave të partive politike.

IV.2 Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2017 ka depozituar pranë Prokurorisë së Tiranë dhe Prokurorisë së Kavajës, 19 kallëzime penale ndaj shtetasve me detyrë anëtarë të Grupeve të Numërimit të votave për 19 qendrat e votimit, pasi kanë konsumuar elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 326, paragrafi i parë i Kodi Penal për Falsifikimin e materialit zgjedhor dhe rezultatit të zgjedhjeve.

Ecuria e këtyre kallzimeve është ndjekur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjatë vitit 2019, ndaj dhe janë pjesë e këtij raporti.

Nga 19 kallëzime, 16 kallëzime janë kompetencë e Prokurorisë së Tiranës dhe 3 kallëzime janë kompetencë e Prokurorisë së Kavajës.



Statusi i kallëzimeve - Prokuroria

- Katërbëdhjetë (14) kallëzime Prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes;
- Pesë (5) kallëzime jemi në pritje të njoftimit të Prokurorisë;

Statusi Kallëzimeve - Gjykata Penale

- Tetë (8) kallëzime Gjykata Penale vendosi pranimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes;
- Gjashtë (6) kallëzime jemi në pritje të njoftimit të Gjykatës;

Kundër vendimeve të gjykatës penale, për 8 kallëzimet e sipërpërmendura, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve depozitoi ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Statusi i Vendimeve - Gjykata e Apelit Tiranë

Nga 8 ankime të depozituara, Gjykata e Apelit ka vendosur:

- Tre (3) ankime vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë (Dhoma Penale);
- Pesë (5) ankime vendosi: Pranimin e Kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorisë për vazhdimin e hetimeve;

Statusi Kallëzimeve (të rihetuara) - Gjykata Penale

Nga 5 ankime për pranimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorisë për vazhdimin e hetimeve të vendosura nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata Penale ka vendosur:

- Një (1) kallëzim ka vendosur dënimin e 3 anëtarëve të Grupeve të Numërimit të votave;
- Katër (4) kallëzime jemi në pritje të njoftimit të Gjykatës;

IV.3 Partneriteti, KQZ-Organizma Ndërkombëtare

Bashkëpunimi permanent me partnerët ndërkombëtarë, asistenca, monitorimi dhe angazhimi i tyre në procesin zgjedhor dhe post zgjedhor kanë qenë jo vetëm një mbështetje e madhe në punën e KQZ-së, por dhe kanë ndihmuar në ngritjen profesionale të administratës së KQZ-së dhe rritjen e standardit të zgjedhjeve në vite.



Në kuadër të transparencës, por dhe të vendosjes së një bashkëpunimi permanent me organizmat ndërkombëtarë, që operojnë në fushën e zgjedhjeve, KQZ është pjesë e një grupi pune i krijuar me iniciativën e OSBE-së, që materializohet në takimin mujor të punës me Election Working Group (EWG), praktikë pune kjo tashmë e konsoliduar. Në këtë vit zgjedhor janë mbajtur gjithsej 12 takime pune, të zhvilluara një herë në muaj në periudhë parazgjedhore dhe duke u intensifikuar në periudhën zgjedhore. Titullari i institucionit dhe pjesë e administratës së KQZ-së kanë qenë prezente në organizimin e këtyre takimeve, ku rregullisht kanë informuar të pranishmit lidhur me veprimtarinë e KQZ-së, problematikat dhe sfidat e ndeshura gjatë punës dhe kanë kërkuar dhe mbështetjen e tyre në trajtimin e problematikave.

Mbështetja me ekspertizë të huaj dhe ngritja e kapaciteteve të administratës zgjedhore në lidhje me financimin e partive politike ka vijuar pa ndërprerje nga ana e Institutit Demokratik Amerikan (NDI) me kontributin dhe mbështetjen e ambasadës britanike. Në këtë vit zgjedhor asistenca konsistoi:

- Në përgatitjen e udhëzuesit për raportimin financiar të fushatës zgjedhore jo vetëm për partitë politike por edhe për kandidatët për kryetar bashkie duke dhënë mbështetjen e plotë për:
- Në përgatitjen e udhëzuesit për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike për fushatën zgjedhore;
- Në standardizimin e formateve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore.

Mbështetja me ekspertizë të huaj dhe ngritja e kapaciteteve të administratës së KQZ-së në lidhje me trajnimin dhe edukimin zgjedhor ka vijuar pa ndërprerje nga ana e Këshillit të Europës (KiE). Në këtë vit asistenca konsistoi:

Në trajnimin dhe çertifikimin e Administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në dy workshop-e, i pari për Planifikimin Strategjik dhe i dyti për Implementimin e Metodologjisë BRIDGE. Zbatimi i metodologjisë ndërkombëtare BRIDGE, e cila përdoret në mbi 40 vende të ndryshme, synon të standartizojë kurrikulën për rritjen profesionale të KQZ-së, dhe edukimin zgjedhor me cilësinë më të mirë bashkëkohore. Ky program u zbatua nga Akademia e Studimeve Politike, dhe me ekspertizën e organizatës “IDEA International” me qendër në Suedi.

Mbështetja e komunitetit ndërkombëtar ka konsistuar në organizimin e tryezave teknike si;



- Tryeza teknike lidhur me keqpërdorimin e burimeve shtetërore në zgjedhje me mbështetjen e Këshillit të Evropës, në përmbushjen me sukses nga ana e KQZ-së të detyrave të ngarkuara me ligj, për rritjen në maksimum të besimit të zgjedhësve në integritetin e procesit,
- Tryeza teknike “Zbatimi i ligjit për dekriminalizimin – mësimet e nxjerra dhe hapat përpara”, me pjesëmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Prokurorisë së Përgjithshme, e organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Tiranë. Duke marrë parasysh faktin se për integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri, parandalimi dhe ndëshkimi i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, ka një rëndësi të madhe, të dy institucionet nënshkruan një memorandum bashkëpunimi i cili synon bashkëpunim serioz dhe të vazhdueshëm midis KQZ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme, përmes shkëmbimit të informacionit, zhvillimit të aplikacioneve kompjuterike të përbashkëta për të ftuar të gjithë qytetarët për të denoncuar shkelje të ligjit ditën e zgjedhjeve.
- Konferenca “Për zgjedhje të ndershme: Të ndalojmë shpërdorimin e burimeve shtetërore”, ku ishte e pranishme dhe administrata e KQZ-së, e organizuar nga Instituti i Studimeve Politike me mbështetjen e Programit të USAID-it në Shqipëri.

IV.4 Vëzhgimi i proceseve zgjedhore

Ndarja e eksperiencave pozitive në trajtimin e mjaft problematikave me të cilat përballen sot Trupat e Menaxhimit të Zgjedhjeve në rajon e më gjerë me synim shkëmbimin e përvojave dhe nxjerrjen e mësimave pozitive, ka qenë dhe fokusi i disa aktiviteteve të zhvilluara:

- Seminare të zhvilluara midis KQZ Shqipëri dhe KQZ Slloveni mbi "Forcimin e pavarësisë së Trupave Zgjedhorë", me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme të Sllovenisë dhe Departamentit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Sllovenisë më 26 Mars, 2019.
- Vizita studimore në Letoni nga datat 1-4 dhjetor 2019, organizuar nga NDI në Shqipëri mbështetur nga Ambasada Britanike në kuadër të projektit “Mbështetja e Rritjes së Transparencën dhe Llogaridhënies për Financat Politike”, për të eksploruar për mënyrën se si Letonia ka rregulluar financat politike. Takimet u mbajtën me përfaqësues të institucionit mbikëqyrës të financave politike në Letoni që është Agjencia Kundër Korrupsionit (KNAB), aktivistë në fushën antikorruption, policinë, partitë politike dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim–Asociimit, përshpejtimit të procesit të integritetit dhe angazhimit të Komisionit Evropian për intesifikimin e mbështetjes për Shqipërinë, u zhvillua në Bruksel takimi i 11-të i Nënkomitetit të Bashkimit Evropian-



Shqipëri me temë 'Drejtësia, Liria dhe Siguria'. Në këtë takim u tregua qartë përparimi i arritur në plotësimin dhe përafrimin e legjislacionit, zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues, forcimin e kapaciteteve administrative, si dhe masat e marra për kapërcimin e vështirësive.

- Pjesëmarrja në Simpoziumin Ndërkombëtar me temë "Përdorimi efektiv i teknologjisë informatike në transparencën dhe auditimin e zgjedhjeve" më 15-17 Shtator, 2019 në Ankara me ftesë të organizatorëve. Siguria kibernetike garanton sigurinë e mjeteve që aplikohen për të ofruar informata autentike për publikun, e cila është thelbësore për çdo Trupë Zgjedhore dhe një nga temat kryesore të diskutimit për ekspertët e zgjedhjeve.
- Vëzhgim i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Austri organizuar me mbështetjen e OSBE-së më 29 shtator, 2019. Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të përpjekjeve për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështjet zgjedhore dhe hartimin e programeve të qëndrueshme të trajnimit për komisionerët zgjedhorë. Në këtë kuadër, vizita krijoi mundësinë që delegacioni të përfitojë nga përvoja austriake në këto fusha. Vëzhgimi i ditës së zgjedhjeve ishte gjithashtu pjesë e programit ku anëtarët e KQZ-së vëzhguan qendrat e votimit.
- Vëzhgim i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të Kosovës të cilat u mbajtën më 6 tetor, 2019.

V. PJESA GJASHTË – VERIFIKIMI I VETËDEKLARIMEVE TË FUNKSIONARËVE PUBLIK (DEKRIMINALIZIMI) NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 'PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE PËR VITIN 2019

Ligji "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", u zbatua në të gjitha vendimmarrjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2019. Ligji përmban dispozita të cilat garantojnë integritetin e figurës së kandidatëve, duke ndaluar kandidimin për t'u zgjedhur në funksione publike të deputetit, kryetarit të bashkisë ose anëtarit të këshillit bashkiak, të personave të cilat kanë kryer veprime ose mosveprime që përbëjnë vepër penale, sipas disa dispozitave të cituara në mënyrë shteruese në këtë ligj.

Për vitin 2019, në zbatim të ligjit të sipërcituar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për shkak të zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, si dhe vakancave të krijuara nga dorëheqjet e deputetëve të subjekteve politike Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, ka shqyrtuar rreth 400 vendime për verifikime për funksionarë publikë (deputetë, kandidatë për deputetë, anëtar këshillash bashkiak dhe kandidat për anëtarë këshilli bashkiak).

V.1 Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit për kandidatët për deputet gjatë plotësimit të vakancave për vitin 2019



Janë kryer verifikime për 46 (dyzete e gjashtë) kandidatë për Deputet, si rezultat i vakancave të krijuara nga Kuvendi i Shqipërisë, respektivisht për 11 kandidatë femra dhe 35 meshkuj.

Si pasojë e njoftimeve nga Kuvendi i Shqipërisë për përfundimin e parakohshëm të mandateve të deputetëve, ka zëvendësuar 24 (njëzet e katër) vakanca nga listat shumemërore të Partisë Demokratike, 17 (shtatëmbëdhjetë) vakanca nga lista shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, 5 (pesë) vakanca nga listat shumemërore të Partisë Socialiste.

Rezultojnë 134 vendimmarrje për mos zgjedhshmëri për shkakun e mosdorëzimit të formularëve të vetëdeklarimit nga ana e kandidatëve të listave shumemërore të subjekteve Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Socialiste. Përkatësisht kanë refuzuar dorëzimin e formularëve të vetëdeklarimit:

- Njëqind e shtatëmbëdhjetë (117) kandidatë të listave shumemërore të Partisë Demokratike;
- Gjashtëmbëdhjetë (16) kandidatë të LSI;
- Një (1) kandidat i Partisë Socialiste.

Nga plotësimi i vakancave të krijuara në Kuvendin e Shqipërisë, aktualisht kanë shteruar listat shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike.

Kandidatët u verifikuan në përputhje me ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike” dhe Vendimin e Kuvendit nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”, brenda afateve të përcaktuara.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar, mbështetur në ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”, dhe Vendimin e Kuvendit nr.17/2016, për 46 (dyzet e gjashtë) kandidatët për deputet, kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit për 46 (dyzet e gjashtë) kandidatët për deputet (formularit të vetëdeklarimit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile), rezultoi se:

- Pesë (5) prej kandidatëve për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, që i përkisnin gjinisë mashkullore, ishin dënuar me burgim me vendim të formës së prerë.

Kandidatët të cilët rezultuan me dënime me burgim me vendim të formës së prerë, referuar nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit,



informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk përfshiheshin në kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas këtij ligji.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjatë vitit 2019, ka administruar dhe ka verifikuar formularët e vetëdeklarimit për 4 (katër) anëtarë të Këshillit të Ministrave.

V.2 Shqyrtime të rezultateve të verifikimeve të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2019

Prokuroria e Përgjithshme në muajin gusht dhe shtator të vitit 2019, i ka kërkuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për 3 kryetar bashkie.

Pas verifikimit të formularit në përputhje me nenin 15, pika 1 të ligjit 138/2015 dhe Kreu VI, pika 6 Kreu V, pika 3, germa “b” e Vendimit të Kuvendit 17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t’ia kaloj rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme.

Në vitin 2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka administruar 3 vendime “Verifikim i Thelluar”, dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit.

- ✓ Me datë 03.05.2019, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, dërgoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimet e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr.138/2015 për anëtarin e keshillit të bashkisë Mirditë, z. Leonardo Gjovalin Nikolli.

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, z. Leonardo Nikolli, përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa “ç” të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për shkak se është deklaruar fajtor për veprën penale “Përdorim i vizave të falsifikuara”, parashikuar nga neni 189/1 i K.P për të cilën është dënuar me 6 (gjashtë) muaj burgim e 400.000 (katërqind mijë) lekë gjobë; përfshihet në fushën e veprimit të pikës 3, germa “ç”, kreu III, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka lejuar vijimin e mandatit të anëtarit të këshillit të bashkisë Mirditë, për shkak se të dhënat anetari nuk përfshiheshin në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015 dhe mos deklarimi i tyre nuk është në kushtet e pasqyrimin të të dhënave të paplota, duke vlerësuar se mosdeklarimi në këtë rast nuk përbën shkak për fshehje të qëllimshme, pasi të dhënat e mosdeklaruara janë të dhëna të cilat janë në regjistrat publik, të cilat janë regjistra zyrtar të institucioneve shtetërore.



- ✓ Më datë 28.10.2019, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Mardhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, dërgoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimet e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr.138/2015 për Kryetarin e Bashkisë Vorë Z. Agim Kajmaku, ndërsa me datë 17.12.2019 ka dërguar vendimin e rezultatit të verifikimit për kandidatin e shpallur fitues për Kryetar bashkia Shkodër, z. Valdrin Pjetri.

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme të dy funksionarët nuk kishin deklaruar në formularin e vetëdeklarimit ndalime, hetime, masa sigurimi personal në fuqi, dënime nga autoritetet e huaja gjyqësore. Përkatësisht z. Agim Kajmaku nuk kishte deklaruar se në momentin e kandidimit ndaj tij kishte një masë sigurie/ urdhër arresti në shtetin Grek dhe në vendet e BE-së, ndërsa z. Valdrin Pjetri nuk kishte deklaruar dënimin dhënë nga autoritetet gjyqësore italiane me 18 muaj burg për veprën penale të “Mbajtjes së paligjshme të lëndëve narkotike”.

Subjektet nuk e kishin deklaruar këtë informacion, dhe pse kishin patur detyrimin ligjor për ta pasyruar në formularin e vetëdeklarimit dhe konkretisht në pikën 3 të formularit “A keni qënë ndonjëherë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?” dhe pikën 4 të formularit, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale?”, i janë përgjigjur me “Jo” të dyja pyetjeve më sipër.

Në KREUN III, pika 3, gërma ç, të vendimit të Kuvendit nr.17/2016, thuhet se formulari (që plotësohet dhe firmoset nga subjektet vetëdeklarues) përmban një rubrikë që detyrimisht pasqyrohet se “...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, sjell përjashtimin e menjëhershë dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”.

KQZ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e funksionarit z. Agim Ymer Kajmaku, në kuadër të zbatimit të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, informacion i ardhur nga institucioni i Prokurorisë krijoi bindjen se funksionarët kanë shkelur dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparencën dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015 “Për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, dhe rregullimet e detajuara të parashikuara në vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

Referuar gërmës ç, pikës 3, Kreut III të Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, z. Agim Kajmaku ishte në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit dhe KQZ vendosi të shpallë pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit me vendimin Nr. 1101 datë 01.11.2019.

Ndërsa për kandidatin e shpallur fitues për funksionin e Kryetarit Bashkia Shkodër, z. Valdrin Luigj Pjetri, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3162 prot. datë 21.08.2019, është njoftuar nga Këshilli i Bashkisë Shkodër për dorëzimin e dorëheqjes së Kryetarit të Bashkisë Shkodër të shpallur fitues z. Valdrin Luigj Pjetri si dhe ka përcjellë dorëheqjen e tij.



V.3 Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për Kryetar bashkie dhe anëtar në këshillat bashkiak, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019, ishin zgjedhjet e para ku u zbatua dhe ligji “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” në këtë magnitudë dhe kompleksitet.

Ligji përmban dispozita të cilat garantojnë integritetin e figurës së kandidatëve duke ndaluar kandidimin për t’u zgjedhur në funksione publike deputetit, kryetarit të bashkisë ose anëtarit të këshillit bashkiak, të personave të cilat kanë kryer veprime ose mosveprime që përbëjnë veprë penale, sipas disa dispozitave të cituara në mënyrë shteruese në këtë ligj.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, depozituan listat shumëmbrore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiak, parti politike, në total 10.153 kandidatë, prej të cilëve 5.189 meshkuj dhe 4.946 femra.

Depozituan në KQZ përveç dokumentacionit të kandidimit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe formularët e vetëdeklarimit, sipas formatit të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”, brenda afateve të përcaktuara, 103 (njëqind e tre) kandidatë për Kryetar Bashkie, prej të cilëve 92 (nëntëdhjetë e dy) meshkuj dhe 11 (njëmbëdhjetë) femra.

KQZ brenda afatit të parashikuar nga neni 73 i Kodit Zgjedhor për verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit, mbështetur në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17/2016, kërkoi informacion për të gjithë kandidatët për Kryetar Bashkie dhe kandidatët për këshillat bashkiak, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit për 10.256 kandidatë (për kryetar bashkie dhe anëtarë këshilli bashkiak) të formularit të vetëdeklarimit, të depozituar nga vetë subjekti, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile, rezultoi se:

1.Kandidatë për Kryetar Bashkie:

- Njëmbëdhjetë (11) kandidatë kishin evidentuar në formularë dënime gjyqësore, masa sigurimi personal, etj;
 - Gjashtë (6) kandidatë kishin dënime penale gjyqësore;
 - Pesë (5) kandidatë ishin hetuar / ndaluar nga organet ligjzbatuese.
- ✓ KQZ refuzoi kandidimin për kandidatin Kryetar Bashkia Himarë për shkak se u verifikuan kushtet e moskandidimit para procesit të pranimit të kandidaturave, vendim i cili u la në fuqi edhe nga Kolegji Zgjedhor;



- ✓ Tre (3) kandidatë të cilët rezultuan me dënime gjyqësore penale ndonëse vepra penale ishte parashikuar në kushtet e ndalimit sipas nenit 2 të Ligjit 138/2015, nuk ishin në periudhën e ndalimit të kandidimit.
- ✓ Dy (2) kandidatë të cilët rezultuan me dënime gjyqësore penale vepra penale për të cilën ishin dënuar nuk përfshihej në kushtet e ndalimit sipas nenit 2 të Ligjit 138/2015.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor dhe nga KQZ, u regjistruan 97 (nëntëdhjetë e shtatë) kandidatë për kryetar bashkie nga të cilët 11 (njëmbëdhjetë) femra dhe 86 (tetëdhjetë e gjashtë) meshkuj.

2.Kandidatët për këshillat bashkiak

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, 36 subjekte politike dhe kandidatë të pavarur, depozituan listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiak në total 10.153 kandidatë, prej të cilëve 5.189 meshkuj dhe 4.946 femra.

Nga verifikimet kanë rezultuar të dënuar me vendime gjyqësore penale 277 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) kandidatë. Nga të cilët, 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë) prej tyre nuk kishin deklaruar dënimet e mëparshme.

Përgjatë verifikimit të tyre, KQZ u ka refuzuar kandidimin 11 (njëmbëdhjetë) kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiak për shkak se u verifikuan kushtet e moskandidimit para procesit të pranimit të kandidaturave.

Kolegji Zgjedhor ka shpallur faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për 4 kandidatë fitues, pasi kushtet e ndalimit u konstatuan pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

KQZ përgjatë vitit 2019 ka dërguar për verifikim të thelluar pranë Prokurorisë së Përgjithshme 8 (tetë) kandidatë fitues për shkak se kanë deklaruar masa sigurimi personal, apo hetime penale jashtë Republikës së Shqipërisë.

V.3.1 Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtar në këshillat bashkiak, gjatë procesit të plotësimit të vakancave të krijuara për vitin 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.138/2015, ka verifikuar formularët e vetëdeklarimit për 106 (njëqind e gjashtë) kandidatë të listave shumëmemërore për këshillat bashkiak për plotësimin e vakancave të krijuara gjatë vitit 2019.

Këshillat bashkiak të zgjedhur në 2015

Përgjatë 4 (katër) muajve të parë të vitit 2019, për vakancat e këshillave bashkiak të zgjedhur në vitin 2015, KQZ ka marrë 13 (trembëdhjetë) vendime për zëvendësimin e 22 (njëzet e dy)



vakancave respektivisht me 12 (dymbëdhjetë) kandidatë të gjinisë mashkullore dhe 10 (dhjetë) kandidate të gjinisë femërore. KQZ për një kandidat ka shpallur faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmerisë së tij.

Këshillat bashkiak të zgjedhur në 2019

Pas konstituimit të këshillave bashkiak të zgjedhur në vitin 2019, kanë dhënë dorëheqjen 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) anëtarë.

Janë zëvendësuar 83 (tetëdhjetë e tre) vakanca gjatë vitit 2019 dhe aktualisht janë në proces zëvendësimi 15 vakanca.

Nga 118 anëtarët e dorëhequr, përbërja gjinore ka qenë si vijon:

- Shtatëdhjetë (70) femra;
- Dyzet e tetë (48) meshkuj.

Për papajtueshmëri me funksionin e anëtarit të këshillit bashkiak janë tërhequr 32 (tridhjetë e dy) anëtarë:

- Njëzet (20) femra;
- Dymbëdhjetë (12) meshkuj.

Nga 118 anëtarët e dorëhequr, 6 (gjashtë) anëtare kishin deklaruar masa sigurimi personal, dënime penale, përkatësisht:

- Një (1) anëtar nuk ka kryer betimin, ndërsa është dërguar për verifikim të thelluar për shkak se kishte deklaruar dëbim nga një vend i BE-se;
- Një (1) anëtar nuk ka qenë në periudhën e ndalimit;
- Katër (4) anëtar nuk ishin në kushtet e ndalimit për shkak se veprat penale/dënimi nuk përfshiheshin në nenin 2 të Ligjit.

Nga 83 (tetëdhjetë e tre) kandidatët e listave shumemërore që kanë zëvendësuar vakancat, kanë marrë mandatin 37 (tridhjetë e shtatë) kandidate femra dhe 46 (dyzet e gjashtë) kandidatë meshkuj.

Përgjatë procesit të zëvendësimit të vakancave të mësipërme, 34 (tridhjetë e katër) kandidatë të cilët janë njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit kanë refuzuar dorëzimin e tij. Nga të cilët:



- Njëzet e një (21) femra;
- Trembëdhjetë (13) meshkuj.

Janë tërhequr nga marrja e mandatit 65 (gjashtëdhjetë e pesë) kandidatë, nga të cilët:

- Pesëdhjetë e shtatë (57) femra;
- Tetë (8) meshkuj.

Këta janë kandidatë të listave shumëmemërore të cilët nuk janë ftuar për të dorëzuar formular vetëdeklarimi / nuk ju ka ardhur akoma rradha për marrjen e mandatit.

Problematika dhe manaxhimi i riskut

Me burime të limituara njerëzore, për shkak edhe të shtrirjes kohore të afateve ligjore të vendosura për dorëzimin e dokumentacionit të kandidimit, verifikimit të formularëve dhe regjistrimit të tyre, KQZ angazhoi gjithë stafin e saj për administrimin, evidentimin dhe verifikimin e formularëve të vetëdeklarimit dhe të dokumentacionit të kandidimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në përvojën e kaluar, përpara fillimit të procesit zgjedhor parashikoi regjistrimin e mbi 35,000 kandidatëve. Për këtë arsye me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të administrimit të formularëve të vetëdeklarimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi ndryshimet në Udhëzimin Nr. 2 datë 29.01.2013, i ndryshuar, “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve”, duke përcaktuar rregulla për dorëzimin e formularëve të vetëdeklarimit dhe për evidentimin e dorëzimit të tyre.

Numri i kandidatëve që dorëzuan formularët e vetëdeklarimit ndonëse më i ulët sesa pritshmëritë, identifikoi problematika të cilat kërkojnë marrjen e masave administrative apo edhe rregullimit të mekanizmave ligjor.

Përgjatë këtij procesi u konstatua se dorëzimi njëherazi i dokumentacionit në limitet kohore të afatit përfundimtar nga ana e subjekteve zgjedhore, krijonte vështirësi në miradministrimin dhe mirë përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit. Administrimi në magnitudë të tillë dhe me afate shumë të ngushta, i një volumi të madh shkresor pamundësonte përpunimin, verifikimin e formularëve brenda afateve ligjore.

Rekrutimi i stafit të përkohshëm nuk realizoi rritjen e cilësisë së administrimit të informacionit/dokumentacionit për shkak të mungesës së trajnimeve dhe përvojës.

Duhet theksuar se në proceset zgjedhore për organet e qerisjes vendore, aktiviteti i KQZ-së shumëfishohet edhe me administrimin e dokumentacionit të kandidimit për bashkitë që nuk mbulohe nga një KZAZ e vetme.



Ky volum me përmasa të mëdha të shtuar edhe me administrimin e formularëve të vetëdeklarimit në përmasa të tilla, kërkon krijimin e mundësive për hedhjen online të formularëve të vetëdeklarimit nga subjektet zgjedhore si dhe krijimin e një sistemi të integruar të informacionit, me qëllim rakordimin e informacionit tek të gjitha agjencitë e angazhuara në procesin e verifikimit dhe gjurmueshmërinë e tyre.

Përgjatë vitit 2019, KQZ ka dërguar mbi 600 kërkesa për verifikim Zyrës së Gjendjes Gjyqësore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për verifikimin e kandidatëve. Një fluks i tillë për informacion, shoqëruar me afate të ngushta ligjore, kërkon domosdoshmërisht aplikimin e sistemeve mbështetëse të teknologjisë së informacionit.

